

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6147
E shtunë, 24 tetor 2020
çmimi 0.40 €

Statistikat e punësimit
tregojnë gjendjen e rëndë
të të rinjve në Kosovë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", NEXHMI RUDARI, KANDIDATI I LDK-së
PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË PODUJEVËS

FAQE 4-5

NUK KEMI ASNJË DILEMË PËR FITOREN E LDK-së MË 29 NËNTOR



Kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryetar të Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka bërë me dije se adresë e vetme politike e qytetarëve të kësaj komune është LDK-ja. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka

e re", ai ka thënë se punët e mira që qeverisja e kësaj partie i ka bërë deri më tani në këtë komunë do t'ia sigurojnë atij fitoren më 29 nëntor. Ai ka shprehur bindjen se këtë garë zgjedhore do ta fitojë qysh në raundin e parë

OPINION

PËRPPJEKJE PËR POLITIZIM
DHE PËRFITIME POLITIKE NGA
VJEDHJA E PARASË PUBLIKE!

F. 11

KMDLNj



AKTUALE



ENDE NUK DIHET NËSE
AKTAKUZA NDAJ THAÇIT ËSHTË
KONFIRMUAR APO HEDHUR
POSHTË

F. 5

RRITET NUMRI I TESTIMEVE PËR
COVID, DY TË VDEKUR EDHE 169
RASTE TË REJA

F. 7

MINISTRI SELIMI: BE-ja,
PRIORITET DHE SYNIM
STRATEGJIK PËR KOSOVËN

F. 7

EKONOMI

MINISTRI KRASNIQI DEL NË
TERREN, VIZITON BIZNESET

F. 8

REÇICA PARALAJMËRON
KOMPANITË: KRIJONI SIGURI
NË VENDIN E PUNËS

F. 8



PARTNERËT E KOALICIONIT QEVERISËS, TË PAKOORDINUAR PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT

Liderët e të tri partive që janë pjesë e koalicionit qeverisës, Isa Mustafa, Ramush Haradinaj dhe Fatmir Limaj, janë takuar të premten dhe kanë diskutuar për zhvillimet e fundit politike dhe ekonomike në vend. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se e kanë parë të nevojshme që të ulen si partnerë të koalicionit dhe të jenë të përgatitur për buxhetin dhe për përpjekjet për ta harmonizuar Ligjin për rimëkëmbjen ekonomike. Liderët e koalicionit qeverisës janë pyetur nga gazetarët edhe për zgjedhjen e presidentit



FAQE 3

TAKOHEN HOTI DHE
ZAEVI: AUTOSTRADA
SHKUP - BLLACË, E
GATSHME PËR DY VJET

FAQE 2



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Takohen Hoti dhe Zaevi: Autostrada Shkup - Bllacë, e gatshme për dy vjet

SHKUP, 23 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka qëndruar të premtën për vizitë në Maqedoninë e Veriut, ku është pritur nga kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev. Hoti dhe Zaevi kanë vlerësuar raportet e deritanishme mes dy shteteve në të gjitha fushat, përfshirë edhe angazhimin e tyre në përbashkë me pandeminë Covid-19.

Të dy kryeministrat gjatë këtij takimi janë përqendruar në veçanti në projektet infrastrukturore, rritjen e bashkëpunimit tregtar si dhe përgatitjen për mbajtjen e mbledhjes së përbashkët mes dy qeverive për konkretizimin e më shumë marrëveshjeve dypalëshe. "Republika e Kosovës dhe Republika e Maqedonisë së Veriut ndajnë interesa të përbashkëta politike dhe ekonomike, për stabilitetin, qëndrueshmërinë dhe prosperitetin e rajonit tonë. Fuqizimi i marrëdhënieve dypalëshe dhe fqinjësisë së mirë është përkushtimi ynë dhe nuk ka alternativë tjetër", ka thënë Hoti. Ai ka thënë se Prishtina do t'i ndjekë përvojat e Maqedonisë së Veriut për realizimin e reformave në ekonomi, por edhe për arritjen e marrëveshjeve me shtetet fqinje që garantojnë paqe dhe stabilitet në rajon.

Kryeministri Hoti ka theksuar se Kosova shpreson që Prishtina të



lidhet me gazin natyror përmes territorit të Maqedonisë së Veriut, por ka thënë se shpreson që të dyja vendet do të krijojnë një pikë të përbashkët kufitare. "Kishim bashkëpunim të ngushtë për përbashkë me pandeminë. Ne gjithçka po bëjmë që t'i përcjellim të gjitha rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare për përbashkë me koronavirusin. Të gjitha masat që merren kanë të bëjnë me parandalimin e virusit dhe jo të lëvizjes së qytetarëve",

është shprehur Hoti. Ndërkaq kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, ka thënë se Maqedonia e Veriut synon që shumë shpejt t'i nisë punët për ndërtimin e autostradës Shkup - Bllacë në drejtim të Kosovës. "Ndërtimi i autostradës Shkup - Bllacë besojmë se do ta rrisë më shumë bashkëpunimin mes dy vendeve. Kjo rrugë, aq sa është e rëndësishme për Kosovën, aq është e rëndësishme për

Maqedoninë (e Veriut). Dy kilometrat e parë veçse duhet të nisin të ndërtohen. Nëse gjithçka shkon mirë, besoj se në tremujorin e parë të vitit të ri do të nisin punimet dhe brenda dy vjetësh të përfundojnë të gjitha punimet", ka deklaruar Zaev, duke theksuar se Kosova mbetet një nga partneret më të rëndësishme tregtare për Maqedoninë e Veriut që, përkundër pandemisë, ka arritur në 170 milionë euro.

Kryeministri maqedonas Zaev tha se i ka bërë ftesë Kosovës që t'i bashkëngjitet iniciativës rajonale të "Mini-shengenit" ballkanik dhe se kjo çështje do të jetë një nga pikat e takimit me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vučić dhe kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama.

Të dy kryeministrat kanë nënshkruar edhe një memorandum të bashkëpunimit për krijimin e rrjeteve të pastra 5G.

Mbahet punëtorja 'Parandalimi i trendeve të reja të delikuencës së të miturve dhe krimit'



PRISHTINË, 23 TETOR (ER) - Drejtoria e Policimit në Bashkësi dhe Preventivë, në përkrahje të misionit të OSBE-së në Kosovë dhe Divizionit të Trajnimeve të PK-së, është duke realizuar punëtorinë njëditore me temë "Parandalimi i trendeve të reja të delikuencës së të miturve dhe krimit".

Qëllimi i punëtorisë në fjalë është ndërgjegjësimi i zyrtarëve policorë për tendencat dhe krimet e reja të delikuencës së të miturve dhe pasojat e tyre në bashkësi. Përveç kësaj, në këtë seminar pjesëmarrësit kanë mundësinë që të marrin informata edhe për risitë në kornizën ligjore (Ligjin për

mbrojtjen e fëmijëve). Seminari në fjalë do të realizohet në të gjitha rajonet policore dhe planifikohet të përfundojë më 5 nëntor. Realizimi i seminareve bëhet për respektim të plotë të masave kundër Covidit të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë.

Mbahet takimi i grupit punues për Strategjinë Shtetërore të Sigurisë Kibernetike

PRISHTINË, 23 TETOR (ER) - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme të premtën është mbajtur takimi i grupit punues për Strategjinë Shtetërore të Sigurisë Kibernetike dhe planin e veprimit 2020-2025. Takimin e hapi koordinatori i Strategjisë, njëherazi zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Zafir Berisha, i cili ka theksuar se prioritet i Ministrisë së Punëve

të Brendshme është zbatimi me sukses i Strategjisë Shtetërore të Sigurisë Kibernetike. Zëvendësministri Berisha ka thënë se ngritja e sigurisë është e domosdoshme në të gjitha institucionet publike dhe se tashmë janë bërë plane konkrete të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe teknologjike. Me këtë rast, nga grupi punues fillimi i muajit

nëntor u përcaktua si objektiv i realizimit të draftit fillestar me qëllim që t'i hapë rrugë kompletimit të Strategjisë së re. Ministria e Punëve të Brendshme është duke hartuar projektligjin për siguri kibernetike, ku qëllimi i këtij ligji do të jetë që t'i përcaktojë parimet e sigurisë kibernetike, parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik në Republikën e Kosovës.



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

Partnerët e koalicionit qeverisës, të pakoordinuar për zgjedhjen e presidentit

Liderët e tri partive që janë pjesë e koalicionit qeverisës, Isa Mustafa, Ramush Haradinaj dhe Fatmir Limaj, janë takuar të premten dhe kanë diskutuar për zhvillimet e fundit politike dhe ekonomike në vend. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se e kanë parë të nevojshme që të ulen si partnerë të koalicionit dhe të jenë të përgatitur për buxhetin dhe për përpjekjet për ta harmonizuar Ligjin për rimëkëmbjen ekonomike. Liderët e koalicionit qeverisës janë pyetur nga gazetarët edhe për zgjedhjen e presidentit



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 TETOR- Të premten janë takuar liderët e tri partive politike që janë pjesë e koalicionit qeverisës, Isa Mustafa, Ramush Haradinaj dhe Fatmir Limaj, ku kanë diskutuar për zhvillimet e fundit politike dhe ekonomike në vend.

Pas takimit, kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka treguar se çfarë është diskutuar në këtë takim me Haradinajn dhe Limajn. "E kemi parë të nevojshme që të ulemi me partnerët e koalicionit dhe të jemi të përgatitur për buxhetin që shkon në procedura tani, si dhe të bëjmë përpjekje për ta harmonizuar Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike.

Çështjen e presidentit dhe të koalicionit nuk e kemi diskutuar. Jemi të përgatitur të shkojmë në zgjedhje nëse dështojmë ta zgjedhim presidentin në afatin që e përcakton Kushtetuta", është shprehur Mustafa.

Ai është pyetur nga gazetarët për çështjen e zgjedhjes së presidentit të vendit.

Lideri i LDK-së ka thënë se vendi shkon në zgjedhje nëse nuk ka pajtim mes partive për zgjedhjen e presidentit. "Po dështuam ta zgjedhim presidentin në afatin kushtetues, atëherë shkojmë në zgjedhje", ka thënë ai.

Lideri i LDK-së ka folur edhe për kohën kur kërkoi vota për presidentin Thaçi, por ka thënë se të njëjtën s'do ta bëjë tani as për Ramush Haradinaj

dhe as për asnjë kandidat tjetër. "As për Haradinajn dhe as për një kandidat tjetër, sepse nuk kemi marrëveshje të tillë. Atëherë i kam kërkuar votat e deputetëve të LDK-së mbi marrëveshjen që kemi pasur dhe për këtë kam pasur edhe shumicën e partisë. Tash s'kemi asnjë obligim ndaj askujt që ta bëjmë president", ka thënë Mustafa.

Ndërkaq ish-kryeministri Ramush Haradinaj, i cili po synon postin e presidentit, nuk ka dhënë përgjigje konkrete për këtë ambicie. "Nuk kam përgjigje në këtë temë", ka deklaruar Haradinaj

në një prononcim për gazetarë. Gjithashtu, ai nuk ka treguar nëse AAK-ja do të dalë ose jo nga koalicioni nëse nuk bëhet president. "Nuk jemi në këtë klimë të daljes dhe të hyrjes. Jemi në punë për ta përkrahur vendin. Për temën e presidentit do ta gjejmë një zgjidhje të duhur për vendin", ka thënë Haradinaj.

Në takimin me partnerët e koalicionit, Haradinaj ka bërë me dije se u diskutua për Ligjin për rimëkëmbje ekonomike. Ndërkaq, për konfirmimin ose jo të aktakuzës ndaj dy bashkëluftëtarëve të tij,

Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli, Haradinaj ka thënë se beson që lufta e pastër e UÇK-së do të vërtetohet. "Kosova ka qenë çdoherë me ligjin. Kemi besuar në të gjitha etapat dhe drejtësia e ka vërtetuar luftën e pastër të UÇK-së. Ne besojmë se edhe në këtë rast do të ndodhë e njëjta. S'lëkundemi në luftën e drejtë dhe për të gjithë luftëtarët e të gjitha niveleve. Duke qenë se Kosova beson në ligj, ne do të vazhdojmë t'i përkrahim qytetarët e Kosovës në bazë të ligjit. Kosova s'mund të pensionohet para ligjit", ka deklaruar lideri i AAK-së.

Statistikat e punësimit tregojnë gjendjen e rëndë të të rinjve në Kosovë

Statistikat e punësimit tregojnë gjendjen e mjerueshme të të rinjve në Kosovë. Shkalla e papunësisë të të rinjtë është 46.4 për qind. Papunësia afatgjatë e të rinjve (15-19), që kanë qenë të papunë për më shumë se 12 muaj, është 39.8 për qind

**EPOKA
ERE** **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 23 TETOR - Në kuadër të Javës Botërore të Statistikave, e cila çdo pesë vjet më 20 tetor nga OKB-ja njihet si Dita Botërore e Statistikave, që këtë vit shënohet nën moton "Lidhja e botës me të dhënat që mund t'i besojmë", Kosovo Liberal Center ka vendosur që shënimin e kësaj jave ta bëjë përmes një videoanimacioni ku përmes statistikave riaktualizohet situata e rëndë e të rinjve në vend, papunësia e të cilëve vazhdon të jetë alarmuese.

Statistikat e punësimit

tregojnë gjendjen e mjerueshme të të rinjve në Kosovë. "Shkalla e papunësisë të të rinjtë është 46.4 për qind. Papunësia afatgjatë e të rinjve (15-19), që kanë qenë të papunë për më shumë se 12 muaj, është 39.8 për qind. Në tremujorin e parë të vitit 2020, 30.3 për qind e të papunëve në Kosovë ishin të rinj (të moshës 15-24 vjeç). Shkalla e papunësisë të rinia e gjinisë femërore është më e lartë (53.6 për qind) krahasuar me meshkujt (42.9 për qind)", thuhet në njoftimin e Kosovo Liberal Center.

Sipas këtij njoftimi, statistikat për vitin 2020 pritet të jenë më të larta, duke pasur për bazë



krizën që po e shkakton pandemia Covid-19. "Gjithashtu, të rinj joaktivë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën, as nuk trajnohen, dmth. janë krejtësisht të shkapitur nga tregu i punës dhe nuk marrin pjesë as në sistemin arsimor përbëjnë 29 për qind të popullsisë së re në vend", thuhet në njoftimin e Kosovo

Liberal Center. Cila është strategjia e Kosovës për zgjidhjen e problemit të punësimit në vend, në kohën e ekonomisë digjitale? "Në të gjithë botën në vitin 2019 vlera e shitjeve online ka qenë 1.53 trilion dollarë. Gjithashtu, 1.9 miliard njerëz kanë kryer aktivitete në e-commerce gjatë vitit 2019. Me këtë rritje të qarkullueshmërisë online

rritet edhe vlera e marketingut onlin, shërbimeve online, rrjedhimisht rritet kërkesa e bizneseve që të digjitalizohen plotësisht", thuhet në këtë njoftim.

Si të qasemi në këtë treg miliardësh? Sipas Kosovo Liberal Center, shteti i Kosovës duhet urgjentisht të marrë disa masa: Rritja për 100 për qind e vlerës së bursave në drejtimet e shkencave kompjuterike, ndërmarrësisë dhe marketingut digjital; ulja e taksave për shkollat e mesme profesionale si dhe kolegjet private që e trajtojnë fushën e teknologjisë me prioritet në kurrikulat e tyre; promovimi i edukimit joformal për ta rritur konkurueshmërinë e të rinjve në tregun e punës; digjitalizimi i gjithë sistemit; lirimi nga taksat për sipërmarrësit e rinj që fushëveprimtari e kanë biznesin online, shërbimet dhe teknologjinë.

Flet për “Epokën e re”, Nexhmi Rudari, kandidati i LDK-së për kryetar të Komunës së Podujevës

NUK KEMI ASNJË DILEMË PËR FITOREN E LDK-së MË 29 NËNTOR

Kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryetar të Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka bërë me dije se adresë e vetme politike e

qytetarëve të kësaj komune është LDK-ja. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se punët e mira që qeverisja e kësaj partie i ka bërë deri më

tani në këtë komunë do t’ia sigurojnë atij fitoren më 29 nëntor. Ai është shprehur i bindur se këtë garë zgjedhore do ta fitojë qysh në raundin e parë

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

realizimin e projekteve të zotuaruara më herët.

PRISHTINË, 23 TETOR - Kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryetar të Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, është shprehur i bindur në fitoren e vet më 29 nëntor. Ai ka bërë me dije se qytetarët e Komunës së Podujevës e kanë vetëm një adresë politike dhe ajo është LDK-ja. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Rudari ka thënë se fitoren e synon pa balotazh. “Qytetarët e kësaj komune e kanë një adresë politike dhe ajo adresë është Lidhja Demokratike e Kosovës. Natyrisht se jemi të bindur se do të fitojmë qysh në raundin e parë, sepse kemi ofertën më të mirë dhe, gjithashtu, kemi bërë punë të mira deri më tani. Pra nuk kemi asnjë dilemë në fitoren tonë më 29 nëntor”, ka deklaruar Rudari.

Ai ka vlerësuar se fitoren do t’ia sjellin punët e mira që deri më tani i ka bërë qeverisja në Podujevë. “Edhe për këtë intervistë po ju lajmërohem nga terreni, ku jam duke i mbikëqyrur punimet për shtrimin e disa rrugëve dhe rrugicave që kanë mbetur në disa fshatra të komunës. Ajo që shoh nga terreni është një disponim i mirë i qytetarëve për këto zgjedhje. Qeverisja jonë ka bërë punë të mira dhe do të vazhdojmë të bëjmë punë të mira”, ka deklaruar ai.

Rudari ka thënë se nuk është sikurse dy kundërkandidatët e tij të cilët nuk jetojnë në Podujevë. “Ne i njohim mirë qytetarët e kësaj komune, sepse jetojmë bashkë me ta në Podujevë. Domethënë unë nuk jam banor rezident i një komune tjetër që të vij e të kandidoj për kryetar të Komunës së Podujevës. Unë jam i lindur këtu, jetoj këtu dhe nuk kam banesë në Prishtinë. Pra më njohin mirë qytetarët e kësaj komune, por edhe unë i njoh ata”, është shprehur Rudari.

Duke treguar për ofertën e tij për qytetarët e kësaj komune, Rudari ka thënë se do ta vazhdojë

“**Epoka e re**”: Z. Rudari, presidenti ka vendosur që më 29 nëntor të mbahen zgjedhjet për kryetar të Komunës së Podujevës. Si e keni parë këtë vendim për këtë datë?

Rudari: Ne e kemi mirëpritur caktimin e datës për zgjedhje në Podujevë. Ne si subjekt politik kemi qenë të përgatitur që zgjedhjet të mbahen edhe në muajin mars, por situata epidemiologjike dihet çfarë ka qenë atëherë dhe është dashur të anulohen. Shpresoj se gjatë kësaj kohe nuk do të kemi rritje të madhe të të infektuarve dhe ky proces zgjedhor do të shkojë ashtu siç duhet.

“**Epoka e re**”: Sa jeni të gatshëm për këto zgjedhje?

Rudari: Ne si subjekt i madh politik, pra si subjekt me traditë në organizim, vazhdimisht kemi pasur kontakte me strukturat tona, me qytetarët e kësaj komune dhe kemi qenë në pritje të caktimit të datës së mbajtjes së zgjedhjeve. Ne kemi qenë dhe jemi të përgatitur për këto zgjedhje.

“**Epoka e re**”: Cila do të jetë oferta juaj për qytetarët e kësaj komune?

Rudari: Ne e kemi programin e punës të cilin e kemi miratuar në zgjedhjet e fundit lokale. Kështu që, ne do të vazhdojmë t’i realizojmë ato premtime dhe zotime që janë të parapara në programin tonë qeverisës katërvjeçar. Dihet se në muajin tetor të vitit të ardhshëm pastaj do të organizohen zgjedhjet e reja lokale dhe për ato zgjedhje do të dalim me program të ri. Ndërsa për këtë mandat do të vazhdojmë t’i zbatojmë të gjitha ato obligime dhe zotime që i kemi marrë para tri vjetësh e gjysmë.

“**Epoka e re**”: Çfarë pritjesh keni për ditën e zgjedhjeve?

Rudari: Edhe për këtë intervistë po ju lajmërohem nga terreni, ku jam duke i mbikëqyrur punimet për shtrimin e disa rrugëve dhe



rrugicave që kanë mbetur në disa fshatra të komunës. Ajo që shoh nga terreni është një disponim i mirë i qytetarëve për këto zgjedhje. Qeverisja jonë ka bërë punë të mira dhe do të vazhdojmë të bëjmë punë të mira. Ne i njohim mirë qytetarët e kësaj komune sepse jetojmë bashkë me ta në Podujevë. Domethënë unë nuk jam banor rezident i një komune tjetër që të vij e të kandidoj për kryetar të Komunës së Podujevës. Unë kam lindur këtu, jetoj këtu dhe nuk kam banesë në Prishtinë. Pra më njohin mirë qytetarët e kësaj komune, por edhe unë i njoh ata. Ua di shqetësimet dhe problemet. Kështu që, besoj se ata do të dinë të përcaktohen drejt në ditën e zgjedhjeve më 29 nëntor.

"Epoka e re": Pse po e përmendni

Ende nuk dihet nëse aktakuza ndaj Thaçit është konfirmuar apo hedhur poshtë

PRISHTINË, 23 TETOR - Dhomat e Specializuara në Hagë nuk e kanë njoftuar ende publikun nëse aktakuza kundër presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, është konfirmuar apo hedhur poshtë. Të shtunën, më 24 tetor, skadon afati prej gjashtë muajsh për gjykatësin e procedurës paraprake të Dhomave të Specializuara në Hagë, për të konfirmuar ose refuzuar aktakuzën, plotësisht ose pjesërisht. Megjithatë, sipas Rregullores së Procedurës dhe Provave të këtyre Dhomave, një gjyqtar, në rrethana të jashtëzakonshme - nëse një prokuror i specializuar paraqet arsye të vlefshme përpara se të konfirmohet aktakuza - mund të lëshojë urdhër të përkohshëm për moszbulimin e aktakuzës para publikut, "për ta parandaluar arratisjen e të akuzuarit, ose për të parandaluar ndonjë ndërhyrje tjetër në procedurë, ose trazirat shoqërore". "Në çdo rast aktakuza do t'i zbulohet publikut, me ndryshime të mundshme nëse është e nevojshme, jo më vonë se paraqitja e parë e të akuzuarit përpara gjykatës", thuhet në rregullin 88 të kësaj Rregulloreje. Gjithashtu, zëdhënësjja e Dhomave, Angela Griep, ka thënë në një deklaratë për "Radion Evropa e Lirë", se Rregullorja e Procedurës dhe Provave nuk parashihet detyrim për ta publikuar vendimin e gjykatës të procedurës paraprake, për hedhjen poshtë

të të gjithave ose disa prej akuzave në aktakuzë. Më 24 prill Prokuroria e Specializuar në Hagë ka paraqitur një aktakuzë për shqyrtim në Dhomat e Specializuara të Kosovës kundër Hashim Thaçit, kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, si dhe disa personave "të tjerë", emrat e të cilëve prokuroria nuk ka dashur t'i publikojë. Në aktakuzën prej dhjetë pikësh thuhet se ata ngarkohen me "disa krime kundër njerëzimit dhe krime

lufte, përfshirë vrasje, zhdukje me forcë, persekutim dhe tortura". Aktakuza pretendon se Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe të dyshuarit e tjerë janë penalisht përgjegjës për gati 100 vrasje. "Viktimat e krimeve në aktakuzë janë qindra njerëz, identiteti i të cilëve është i njohur dhe në mesin e të cilëve ka shqiptarë të Kosovës, serbë, romë dhe njerëz të kombësive të tjera, si dhe kundërshtarë politikë", është thënë në deklaratë. Nëse gjykatësi i procedurës

paraprake bindet se dyshimi i vërtetuar nga ana e prokurorit ka bazë, gjykatësi e miraton aktakuzën. Nëse nuk bindet, aktakuza hidhet poshtë. Pas konfirmimit të aktakuzës, i dyshuari merr statusin e të akuzuarit dhe aktakuza i dorëzohet personalisht të akuzuarit. Paraqitja e parë e të akuzuarit në gjykatë mbahet brenda shtatë ditësh, pas dorëzimit të aktakuzës. Thaçi ka thënë më herët se do të japë dorëheqje nëse aktakuza konfirmohet.



çështjen e banimit? Kundër-kandidatët tuaj nuk jetojnë në Podujevë?

Rudari: Jo. Ata asnjëri nuk jetojnë në Podujevë. Të dytë jetojnë në Prishtinë. Njëri në Prishtinë e tjetri në Bërnice. Ata në Podujevë vijnë vetëm gjatë fundjavës.

"Epoka e re": Mendoni se nuk është e drejtë të kandidohet për kryetar të komunës nëse nuk jeton aty?

Rudari: Njerëzit kanë të drejtë të jetojnë ku të duan, mirëpo ata që jetojnë me qytetarët e kësaj komune janë më afër shqetësimeve të tyre dhe i njohin më mirë problemet e tyre sesa ata që vijnë vetëm në fundjavë.

"Epoka e re": Besoni se kjo do të jetë një përparësi për ju?

Rudari: Natyrisht se kjo është përparësi për mua, sepse jetoj këtu, i njoh dhe më njohin më mirë njerëzit e kësaj komune. Ndërsa, siç thashë, ata vijnë vetëm gjatë fundjavës.

"Epoka e re": Pretendimet e tyre janë se do ta fitojnë këtë garë zgjedhore. Sidomos kandidati i LV-së, Shpejtim Bulliqi, është shprehur i bindur se do të fitojë më 29 nëntor.

Rudari: Ai po harron se më nuk është në LDK. Ka qenë rreth 28 vjet në këtë parti, por nuk është më. Sigurisht se po llogarit në votat e LDK-së për t'u bërë

kryetar. Ai duhet ta dijë se LDK-ja nuk ka vota për kandidatët e partive të tjera. Votat e LDK-së janë për kandidatin e kësaj partie. Ai ende nuk po e kupton se më nuk është në LDK, por është kandidat i LV-së.

"Epoka e re": Sa besoni se do të arrini ta mbron bastionin e LDK-së?

Rudari: Mendoj dhe jam shumë i bindur se qytetarët e kësaj komune do të dinë ta vlerësojnë secilin prej kandidatëve për kryetar dhe, gjithashtu, subjektet politike që ata përfaqësojnë. Pra ata më njohin mua dhe partinë që e përfaqësoj. Unë prej dhjetë vjetësh kam qenë në shërbim të

tyre, qoftë si drejtor i arsimit dhe si nënkryetar i komunës për një mandat e gjysmë. Kështu që, e kanë më të lehtë të zgjedhin. Pra qytetarët kanë një adresë. Ajo është LDK-ja.

"Epoka e re": Fitoren e synon në raundin e parë apo të dytë?

Rudari: E thashë se qytetarët e kësaj komune e kanë një adresë politike dhe ajo adresë është Lidhja Demokratike e Kosovës. Natyrisht se jemi të bindur se do të fitojmë qysh në raundin e parë, sepse ne kemi ofertën më të mirë dhe kemi bërë punë të mirë deri më tani. Në këtë mënyrë nuk kemi asnjë dilemë në fitoren tonë më 29 nëntor.

'Jam i pafajshëm', thotë punëtori i Thesarit



PRISHTINË, 23 TETOR - I dyshuari për transaksionin e paligjshëm mbi 2 milionë euro nga Thesari i Kosovës, Labinot Gruda, ka deklaruar në gjykatë se ndihet plotësisht i pafajshëm dhe se pretendimet për këtë shumë parash "nuk kanë të bëjnë aspak" me të. "Unë gjithmonë i kam përmbushur detyrimet e mia sipas përshkrimit të vendit të punës dhe asnjëherë nuk i kam tejkaluar ato", ka deklaruar Labinot Gruda gjatë seancës dëgjimore të mbajtur të enjten në Gjykatën Themelore të Prishtinës, pas së cilës i është caktuar masa e paraburgimit prej një muaji në bazë të kërkesës së prokurorit. Kjo deklaratë citohet në aktvendimin e gjykatës, në të cilën "Radio Evropa e Lirë" ka pasur qasje. Gjykata thotë se Gruda dyshohet për kryerjen e veprës penale "keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar". Sipas deklaratës së prokurorit të rastit, Labinot Gruda më 9 tetor, mes orës 12:11 dhe 12:19, nga zyra e vet në Thesarin e Kosovës, "duke krijuar user-a (llogari) të ndryshëm si user-a të punëtorëve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe të njëjtat i ka përdorur në mënyrë të kundërligjshme, ka realizuar katër transaksione në vlerë prej 2,077,995 eurosh në llogarinë bankare të kompanisë 'LDA Group' Sh.p.k..., veprime të cilat i kanë shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës". Punëtori i Thesarit, Gruda, megjithatë ka deklaruar se është e pamundur që

transaksionin ta ketë kryer nga ora 12:11 deri në orën 12:19, përkatësisht për 8 minuta. "Nëse e marrim mënyrën reale të ekzekutimit të një transaksioni, duhet të kalojë nëpër duart e së paku pesë zyrtarëve, t'i marrë të gjitha nënshkrimet apo aprovimet e duhura, gjë që nuk mund të arrihet të kryhet një transaksion i tillë në afatin kohor prej 8 minutash", ka thënë ai. Në vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë shkruan se Prokurori i Shtetit gjatë seancës dëgjimore ka thënë se "personave të cilëve iu janë bartur mjetet, veç sa e kanë lëshuar territorin e Kosovës dhe nuk janë të qasshëm për organet gjyqësore, ndërsa mjetet nga llogaria veç se janë tërhequr apo janë dërguar në llogari të tjera". Prokuroria tha se e bazon kërkesën për paraburgim ndaj Grudës pasi ekziston rreziku se i dyshuari "do t'i asgjësojë, fshehtë, ndryshojë apo falsifikojë provat apo gjurmët e veprës penale si dhe ta pengojë rrjedhën e suksesshme të procedurës penale me ndikim të dëshmitarët, të të dëmtuarit apo pjesëmarrësit". Mbrojtësi i të dyshuarit, Veton Rrecaj, gjatë seancës dëgjimore, duke e kundërshtuar masën e paraburgimit, ka deklaruar se "mungon kushti esencial, dyshimi i arsyeshëm se i mbrojturi në mënyrë individuale-personale të ketë

ndërmarrë veprime inkriminuese në drejtim të veprës penale për të cilën dyshohet". Sipas avokatit Rrecaj, Gruda në zyrë në Thesar punonte me 13 persona të tjerë, duke shtuar se i mbetet organit të hetuesisë që në të ardhmen ta vërtetojë dyshimin, përkatësisht veprimin që klienti i tij ka ndërmarrë, për t'i transferuar këto mjete në një kompani private. Sipas avokatit, i dyshuari gjatë ndalimit në polici ka shfrytëzuar të drejtën e tij për t'u mbrojtur në heshtje për arsye se ka qenë "tejet i shqetësuar dhe i tronditur nga këto dyshime tërësisht të pabazuara". Labinot Gruda, punëtor i Thesarit, është arrestuar më 20 tetor derisa dy persona të tjerë, pronarë të kompanisë private së cilës i është bërë transferimi, gjenden në arrati. Ministria e Financave, Hykmete Bajrami, gjatë një raportimi të enjten para Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike, tha se transferimi i mbi 2 milionë eurove nga Thesari i Kosovës në llogarinë e një kompanie private është realizuar përmes një krimi kibernetik. "Ky është krim ekonomik i realizuar përmes një krimi të thellë kibernetik, ku janë bërë qasje të paautorizuara, janë tejkaluar autorizimet ligjore, është bërë keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe janë thyer pasvordet (fjalëkalimet)", ka thënë Bajrami.

KUSH KA TË DREJTË TË BËJË TRANSFERIME PARASH NË THESAR?

Thesari i Kosovës, që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave, është përgjegjës për menaxhimin e fondeve të Republikës së Kosovës. Sipas Ministrisë së Financave, në Thesar transferimi i parave bëhet përmes Sistemit Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës, i njohur me shkurtesën SIMFK. Në këtë sistem, përveç punëtorëve të Thesarit, qasje në të kanë edhe nononjësit e organizatave të tjera buxhetore që caktohen nga organizatat përkatëse. Personat që bëjnë transferime parash, paraprakisht trajnohen dhe certifikohen për këtë gjë. Përdoruesi i sistemit SIMFK në momentin që pranon kërkesën e aprovuar nga Thesari për qasje në këtë sistem, e bën regjistrimin, i caktohet ID e përdoruesit, fjalëkalimi, klasa funksionale dhe grupi i sigurisë. Numri identifikues dhe fjalëkalimi i jepen vetëm shfrytëzuesit. Klasat funksionale, e që janë 33 të tilla, përcaktojnë qasjen në funksione të caktuara për përdoruesit, sipas përgjegjësisë që ka. Nga këto klasa, qasje në të gjitha

funksionet dhe modulet e sistemit mund të ketë vetëm udhëheqësi i Divizionit për Menaxhim dhe kontroll të brendshëm dhe analistë funksionalë, si dhe ndonjë zyrtar alternativ me autorizim të zëvendës drejtorit të operimeve. Në klasë tjetër kanë të drejtë të kenë qasje zyrtarët e organizatave buxhetore, zyrtarë të regjistrimit të pasurive, zyrtarët zotues për kërkesa për blerje, e të tjera. Por, të gjithë këta persona zyrtarë kanë kode dhe fjalëkalime të ndryshme për të realizuar transferimet, kurse në Divizionin e Pagesave në Thesar të drejtë kanë vetëm punëtorët e Thesarit. Personat përgjegjës për realizimin e transferimeve vazhdimisht monitorohen dhe kontrollohen nga zyrtarët e tjerë. Çdo transferim në fund të ditës verifikohet, kryesisht kur transferimi ka të bëjë me një shumë të madhe parash. Monitorimin e këtyre transferimeve të parave e bën një departament tjetër, i cili më pas e kompletton dosjen e pagesave të të gjitha organizatave buxhetore.

Raporti 24-orësh i Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) për rastet me Covid-19

Rritet numri i testimeve për Covid, dy të vdekur edhe 169 raste të reja

Kosovës të premten i janë shtuar 169 raste të reja me Covid-19, pas marrjes së 1 119 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve janë regjistruar dy viktima. Sipas të dhënave të këtij instituti, të premten janë regjistruar edhe 85 raste që kanë mposhtur virusin, kurse raste aktive aktualisht janë 1 953



Brenda 24 orëve janë raportuar dy raste të vdekjes me Covid-19. Numri total i rasteve pozitive

është 17 591 raste nga 85 042 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 659 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 85 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 14 979 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1953. Rastet e fundit pozitive janë nga: komuna Prishtinë 71 raste, komuna Pejë 20 raste, komuna Gjiilan 16 raste, komuna Podujevë 15 raste, komuna Gjakovë 9 raste, komuna Prizren 8 raste, komuna Fushë-Kosovë 6 raste, komuna Obiliq 6 raste, komuna Ferizaj 4 raste, komuna Klinë 4 raste, komuna Deçan 2 raste, komuna Skenderaj 2 raste, komuna Suharekë 2 raste dhe me nga një rast komunat Istog, Lipjan, Shtime dhe Shtërpçë.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 TETOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës

(IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 119 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 169 raste pozitive me Covid-19.

Ministri Selimi: BE-ja, prioritet dhe synim strategjik për Kosovën

Prishtinë, 23 tetor (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka pritur të premten në takim shefin e Zyrës së BE-së/përfaqësuesin e posaçëm të BE-së në Prishtinë, Tomas Szunyog. Në këtë takim, ministri Selimi ka vlerësuar bashkëpunimin e ngushtë që Ministria e Drejtësisë ka me Zyrën e Bashkimit Evropian, e cila ka ofruar mbështetje të vazhdueshme përmes projekteve të cilat kanë sjellë cilësi, ekspertizë dhe infrastrukturë në sistemin e drejtësisë.

Në takim, po ashtu, u shkëmbyen pikëpamjet mbi rezultatet e reformës në drejtësi, veçanërisht procesi i rishikimit funksional i sundimit të ligjit dhe procesi i llogaridhënies duke përfshirë vettingun si pjesë e reformës, përmes të cilave synohet ngritja e llogaridhënies, efikasitetit dhe profesionalizmit në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Përveç agjendës legislative, ministri Selimi dhe shefi i Zyrës së BE-së kanë diskutuar edhe për procesin e liberalizmit të vizave si dhe detyrat të cilat e presin Kosovën në rrugën drejt integritit evropian, me ç'rast ministri Selimi ritheksoi se Bashkimi Evropian mbetet synimi strategjik i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe për këtë institucionet e vendit janë të përkushtuara për avancimin e agjendës për integritim. "Fuqizimi i sundimit të ligjit dhe lufta e pakompromis kundër korrupsionit janë rruga e vetme e Kosovës dhe garantuese për të ardhmen e saj në Bashkimin Evropian", ka thënë ministri Selimi.

Në kuadër të takimit ministri Selimi ka shprehur shqetësimin për moszbatimin e marrëveshjeve të Brukselit nga ana e Serbisë, e cila vazhdon ta keqpërdorë Interpolin për ndalimin e qytetarëve të Kosovës. Nga ana tjetër, shefi i



Zyrës së BE-së/përfaqësuesi i posaçëm i BE-së, Tomas Szunyog, ka theksuar se Bashkimi Evropian vazhdon të jetë i përkushtuar për të çuar më tej bashkëpunimin e ngushtë që ka me të gjitha institucionet e Kosovës për ta ndihmuar në

proceset e zhvillimit të përgjithshëm si dhe bashkëpunimin rajonal dhe integritin evropian.

Në përfundim të takimit, ministri Selimi duke falënderuar Szunyogin për bashkëpunimin e deritanishëm ka theksuar se

mbështetja e Bashkimit Evropian është shumë e rëndësishme për vazhdimësinë e reformave në Kosovë dhe avancimit të agjendës të integritit, e cili mbetet një nga synimet kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ngrehet aktakuzë për tregti të ndaluar dhe shpëlarje të parave



PRISHTINË, 23 TETOR (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngrehur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Speciale, kundër të pandehurit M. G. për veprat penale "Tregti e ndaluar" si dhe për "Shpëlarje të parave". Prokuroria Speciale njofton se i pandehuri M.G. më 14.08.2020, është hasur duke ushtruar veprimtari ekonomike pa autorizim dhe pa leje përkatëse, pasi që në veturën e tij janë gjetur mjete monetare të fshehura në

valutën euro, të padeklaruara gjithsej gjashtëdhjetë e pesëmijë e katërqind e pesëdhjetë euro (65,450.00 euro), për të cilat mjete i pandehuri nuk i kishte deklaruar, e që janë sekuestruar nga Prokuroria Speciale sipas Urdhëresës të Gjyqtarit të Procedurës Paraprake të Gjykatës Themelore Prishtinë, Departamenti Special.

Me këto veprime i pandehuri i lartcekur ka kryer veprën penale, "Tregti e ndaluar".

Po ashtu, i pandehuri M.G. më 14.08.2020, duke e ditur apo

duke pas arsye të dija se ishte duke bartur mjete monetare, të fshehura në automjetin e tij, duke i pasur në posedim ka tentuar që të fshehtë ose maskon natyrën e vërtetë, burimin, vend-ndodhjen, sistemimin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me pronësinë e kësaj pasurie, apo në çfarëdo rrethanash, me qëllim që të shkaktoj shmangien nga pasojat juridike ose pasojat e mundshme ligjore. Me këto veprime i pandehuri ka kryer veprën penale, "Shpëlarja e parave".

Ministri Krasniqi del në terren, viziton bizneset

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 TETOR - "Prodhuesi vendor është dhe do të jetë prioritet i mbështetjes gjatë mandatit tim si ministër i Tregtisë", ka thënë ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, pas vizitës që u ka bërë disa bizneseve prodhuese në Komunën e Suharekës. Ministri Krasniqi, pasi është njoftua me problemet e shkaktuara nga pandemia, ka thënë se, pas votimit në lexim të dytë të pakos për rimëkëmbje ekonomike, do të ndihmohen të gjitha bizneset. "Kemi marrë iniciativë që t'i vizitojmë bizneset prodhuese në vendin tonë për t'i parë nga afër problematikat të cilat ua ka shkaktuar pandemia Covid-19. Ne si MTI, së bashku me kabinetin qeveritar, do të

bëjmë përpjekje që t'u dalim në ndihmë dhe të gjitha sugjerimet e tyre do t'i vendosim në veprim. Kemi miratuar në lexim të parë projektligjin për rimëkëmbje ekonomike. Shpresojmë që shumë shpejt do të kalojë edhe lexim në të dytë dhe në këtë formë do të kemi mundësi t'i ndihmojmë bizneset", ka thënë Krasniqi.

Në këtë vizitë ministrin Krasniqi e shoqëroi edhe kryetari i Suharekës, Bali Muharremaj, i cili kërkoi mbështetje nga ky i fundit për krijimin e një zone industriale në Biraq.

Pronari i kompanisë "Frutex", Shaqir Palushi, e njoftoi ministrin Krasniqi me sfidat dhe vështirësitë që janë ballafaquar si pasojë e pandemisë. "Parashtruar disa kërkesa të cilat mendoj se



sektori prodhues si sektor strategjik, që të ndihmohet goftë përmes lirimeve tatimore

apo tatimit në fitim në vlerën e eksportit. Mendoj se këto kërkesa nëse realizohen dhe

masat me pakon emergjente do ta zbusin ndikimin negativ nga pandemia", ka thënë Palushi.

Në takimin vjetor të FMN-së, Bajrami flet për sfidat me të cilat po përballet ekonomia e Kosovës

PRISHTINË, 23 TETOR (ER) - Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka marrë pjesë në takimin vjetor të FMN-së të kryesuar nga drejtoresha menaxhuese e FMN-së, Kristalina Georgieva. Kjo ishte hera e parë që Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës i rezervohet mundësia e adresimit si paneliste në takimin e nivelit të lartë të FMN-së.

Ministrja Bajrami ka falënderuar FMN-në për këtë mundësi dhe për mbështetjen e FMN-së në menaxhimin e pandemisë si dhe për bashkëpunimin e ngushtë në fushën e menaxhimit të financave publike dhe ruajtjen e stabilitetit makrofiskal në vendin tonë. Ministrja Bajrami ka folur për



sfidat me të cilat po përballet ekonomia e Kosovës në kontekstin e krijuar nga pandemia duke u përqendruar në nevojën për një politikëbërje adekuate e

cila adreson në mënyrë efektive dhe të shpejtë problemet socio-ekonomike e ato shëndetësore të krijuara si rezultat i pandemisë.

Bajrami ka theksuar se Kosova

dhe vendet e rajonit duhet të adresojnë në mënyrë të kujdesshme dhe të analizuar mirë hapësirën fiskale si dhe ta forcojnë kapacitetin absorbues në mënyrë që financimi i

projekteve të prodhojë rezultate pozitive. "Nëvizova se edhe në periudhën vijuese mbeten sfida të rëndësishme për t'u adresuar, sikurse çështja e parashikueshmërisë, përkatësisht e pasigurisë që ndërlidhet me shkallën e dëmit ekonomik të krijuar nga pandemia te bizneset si dhe reflektimit të këtij ndikimi te të hyrat buxhetore të shtetit. Po ashtu, nëvizova se në kuadër të politikave tona publike ne si qeveri duhet të përballemi me dilemat e pashmangshme për të gjetur balancë ndërmjet investimeve publike në shëndetësi, arsim, në sektorin privat dhe në fusha të tjera, gjithnjë duke pasur në konsideratë grupet e cenuara dhe kategoritë sociale", ka shkruar Bajrami në llogarinë e vet në "Facebook".

Abrashi: Dragashin do ta kthejmë në një zonë të rëndësishme turistike

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, bashkë me zëvendësministrin Hamza Balje, kanë vizituar Komunën e Dragashit, në të cilën janë duke u kryer disa projekte infrastrukturore. Ministri Abrashi është ndalur te punimet në rrugën Zhur-Dragash, në të cilën është duke u bërë zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës. Abrashi ka theksuar se zgjerimi i rrugës është prioritet i Ministrisë së Infrastrukturës dhe krijon më shumë siguri për

pjesëmarrësit në komunikacion. Më pas ministri, bashkë me kryetarin e Komunës së Dragashit, Shaban Shabani, kanë vizituar edhe punimet që po zhvillohen në rrugën për Zaplluxhë. Kjo rrugë është duke u rehabilituar me një shtresë të re të asfaltit dhe duke u zgjeruar, që është projekt i Ministrisë së Infrastrukturës.

Abrashi ka thënë se kompletimi i infrastrukturës në Komunën e Dragashit do t'i shërbejë zhvillimit të turizmit dhe rritjes së vendeve të punës. "Jemi në

përfundim e sipër të asfaltimit dhe zgjerimit të rrugës nga Zaplluxha deri në Tyrbe, bazuar në memorandumun në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Dragashit. Asfaltimi i kësaj rruge është me rëndësi të madhe për banorët e kësaj ane dhe ndikon në zhvillimin e turizmit dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Po punojmë për kompletimin e infrastrukturës së Dragashit, për ta kthyer në një zonë të rëndësishme turistike për Kosovën", është shprehur Abrashi.



Veseli në Pejë: Qeveria ta ndihmojë prodhimtarinë

“Ekonomia jonë mund të ecë përpara vetëm nëpërmjet lulëzimit të sipërmarrjeve private në kushtet e një konkurrence të lirë e të ndershme dhe nëpërmjet një integrimi sa më të mirë të ekonomisë sonë në tregjet ndërkombëtare. Prandaj sektori i prodhimit në ekonominë e Kosovës meriton vëmendje shumë më të madhe se deri tani prej qeverisë, sidomos duke ditur që është dëmtuar nga pandemia”, ka thënë kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, gjatë vizitës që ua ka bërë disa bizneseve në Pejë

PEJË, 23 TETOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka qëndruar të premten në Pejë, ku ka vizituar disa biznese të cilat janë prekur nga pandemia. Gjatë vizitës në kompaninë “Greenhouse” dhe “Ved-Farm”, kryetari Veseli ka theksuar edhe një herë nevojën e ndihmës konkrete nga qeveria për bizneset e Kosovës, veçanërisht tani gjatë pandemisë. “Ekonomia jonë mund të ecë përpara vetëm nëpërmjet lulëzimit të sipërmarrjeve private në kushtet e një konkurrence të lirë e të ndershme dhe nëpërmjet një

integrimi sa më të mirë të ekonomisë sonë në tregjet ndërkombëtare. Prandaj sektori i prodhimit në ekonominë e Kosovës meriton vëmendje shumë më të madhe se deri tani prej qeverisë, sidomos duke ditur që është dëmtuar nga pandemia”, ka thënë Veseli. Kompania “Greenhouse” prodhon shtëpi të parafabrikuara prej druri të cilësisë së lartë duke eksportuar në Zvicër, Austri dhe vende të tjera të Evropës së Veriut. Ndërkaq kompania “Ved-Farm” është investim serioz që përdor fjalën e fundit të shkencës për të

prodhuar vezë cilësore. “Zgjerimi i kompanive si këto të dyja dhe i këtij sektori prodhues në përgjithësi mundëson shtimin e vendeve të reja të punës që sigurojnë të hyra për shumë familje. Po ashtu, rrit të hyrat në buxhetin e shtetit që mund të përdoren për t’i përmirësuar shërbimet publike dhe infrastrukturën. Rritja e prodhimit vendas gjithashtu kontribuon në uljen e çmimeve për konsumatorin tonë duke ulur koston e jetës dhe përmirësuar standardet e jetës së qytetarëve të Kosovës”, ka thënë Veseli.



Reçica paralajmëron kompanitë: Krijoni siguri në vendin e punës

PRISHTINË, 23 TETOR - Në kuadër të përmbylljes së “Javës Evropiane për Siguri dhe Shëndet në Punë”, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica, ka vizituar fabrikën “NewCo Ferronikeli”. Reçica me këtë rast ka thënë se do të jenë bashkë me inspektoratin në terren për të monitoruar se në çfarë kushte punojnë punëtorët dhe sa kanë siguri në vendet e punës. Ai ka shtuar se do të jenë të pakompromis ndaj atyre që nuk

respektojnë ligjet në fuqi. “Ndodhemi këtu në Ferronikel ku u informuam për punën që bën kjo industri për angazhimet e tyre në drejtim të ofrimit të kushteve më të mira të përmirësimit të sigurisë dhe shëndetit në punë. Ka këso fabrika si kjo që, përkundër problemeve në rrethana pandemish, kanë sigurinë e punëtorëve. Në u zotuar që kurdo, por 350 ditë bashkë me inspektoratin do të jemi në terren

ku nuk respektohen të drejtat e punëtorëve me qëllim që t’i bindim punëdhënësit se puna e punëtorit është më e rëndësishmja”, ka thënë ai, duke shtuar se të drejtat e punëtorëve mbeten prioriteti i ministrisë që drejton. “Tani ne kemi në procedurë Ligjin e inspektoratit i cili është në pritje për t’u miratuar në Kuvend. Do të jemi të pakompromis ndaj atyre që nuk respektojnë masat në vendin e punës”, ka thënë ministri Reçica.



Austria rikonfirmon bashkëpunimin për sektorin e bujqësisë

PRISHTINË, 23 TETOR (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka zhvilluar të premten një takim me ambasadorin e Austrisë, Christoph Weidinger, ku është

njoftuar edhe me udhëheqësen e re të Zyrës Koordinuese për Bashkëpunim Zhvillimor të Austrisë në Prishtinë (ADA), Sandra Horina. Ministri Mustafa me këtë rast i njoftoi me proceset

zhvillimore në sektorin e bujqësisë si dhe me reformat e vazhdueshme me qëllim të rritjes së përkrahjes për bujqit tanë. Në anën tjetër, ambasadori Weidinger dhe udhëheqësja e re e Zyrës

Koordinuese për Bashkëpunim Zhvillimor të Austrisë (ADA), Sandra Horina, falënderuan ministrin Mustafa për pritjen dhe rikonfirmuan bashkëpunimin në mes të dy shteteve.



PDK-ja: Qeveria komunale e ka sjellë arsimin në Prizren buzë kolapsit total

PRIZREN, 23 TETOR (ER) - Dega e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prizren ka kritikuar qeverisjen e Mytaher Haskukës në këtë qytet. Kritikën e kësaj partie këtë herë janë në adresë të arsimit. "PDK, Dega në Prizren, njëjtë sikurse qytetarët e Komunës së Prizrenit, jemi të shqetësuar për gjendjen e rëndë që e ka kapluar arsimin në Komunën e Prizrenit. Komisioni për Arsim i PDK-së, pasi ka analizuar hollësisht situatën e krijuar me rastin e fillimit të vitit shkollor edhe ashtu të vështirë për shkak të pandemisë, ka konstatuar se qeveria komunale me veprimet e veta e ka sjellë arsimin në Prizren buzë kolapsit total", është

thënë në reagimin e kësaj partie. Sipas PDK-së në Prizren, situata në arsim ditaditës po degradon. "DKA asnjëherë që nga pas lufta nuk ka qenë e instrumentalizuar dhe e politizuar më keq se në këtë qeveri. Ka tash e tre vjet që në këtë drejtori e kanë humbur kuptimin fjala arsim dhe institucion arsimor. Në këtë drejtori nuk dihet më se kush çfarë detyre ka, pasi çdo veprim bëhet me direktiva politike të LV-së. Vendimet merren nga të autorizuarit e kryetarit dhe nënshkruhen kutrum nga drejtoresha e instrumentalizuar e DKA-së", është theksuar në komunikatën e PDK-së në Prizren.



Në Komunën e Malishevë angazhohen 30 praktikantë

MALISHEVË, 23 TETOR (ER) - Në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës (APRK) me Komunën e Malishevës janë angazhuar 30 praktikantë në administratën e Komunës së Malishevës, të cilët janë të regjistruar si punëkërkuar në Zyrën e Punësimit, ndërsa do të jenë të angazhuar në punë praktike për gjashtë muaj. Për këtë qëllim, të premtën të gjithë këta praktikantë të angazhuar në punë në Malishevë i ka takuar i pari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, së bashku me kabinetin e tij. "Dua t'ju



njoh të gjithëve dhe t'ju rikujtoj se qëllimi i angazhimit tuaj është që ju ta mësoni punën në praktikë në administratën komunale në përgjithësi dhe ta mësoni sistemin e punës në të gjitha shërbimet administrative dhe komunale. Pas kësaj

përvojë që ju do ta fitoni, do ta keni më të lehtë të konkurroni për punë, ose kur të punësoheni do ta keni përvojën e mjaftueshme për punë", ka thënë Begaj gjatë takimit me praktikantët e angazhuar në punë në Komunën e Malishevës.

Vazhdon realizimi i projekteve në 55 vendpunishte

DRENAS, 23 TETOR (ER) - Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria e Infrastrukturës Lokale, është duke vazhduar punimet në 55 vendpunishte aktive që janë duke u realizuar në vendbanime, projekte këto që janë në shërbim të qytetarëve. Për t'i parë nga afër punët në terren, drejtori i Infrastrukturës Lokale, Endrit Gllareva, së bashku me stafin e drejtorisë, kanë vizituar projektet që janë duke u implementuar. Gllareva ka thënë se, përkundër vonësive të shkaktuara nga gjendja e pandemisë globale Covid-19, janë duke punuar me kapacitete të plota në terren në mënyrë që të kryhen punimet sipas planifikimit dhe standardeve të kërkuara. Projektet të cilat



janë duke u realizuar në vendbanime janë në kuadër të projekteve të planifikuara për t'u realizuar gjatë këtij viti.

Ahmeti thotë se në Qendrën e Mjekësisë Urgjente janë rinovuar të gjitha hapësirat e objektit



PRISHTINË, 23 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka vizituar Qendrën e Mjekësisë Urgjente. Ai ka thënë se investimi i vazhdueshëm në ngritje të kapaciteteve dhe infrastrukturë siguron

përmirësim të cilësisë së shërbimeve të shëndetit parësor në kryeqytet. "Në Qendrën e Mjekësisë Urgjente janë rinovuar dhe inventarizuar tërësisht të gjitha hapësirat e objektit, hapësirat e parkimit dhe oborri me hapësirat e

gjelbërimit rreth objektit. Krejt kjo ndihmon që shërbimet ndaj qytetarëve të avancohen vazhdimisht duke e mbajtur kohën e intervenimit në raste urgjente nën mesataren e gjashtë minutave", ka thënë Ahmeti.

Rudari angazhohet për mbështetjen e blegtorëve llapjanë

Podujevë, 23 tetor (ER) - Nën kryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka pritur të premtën në takim përfaqësuesit e OJQ

"Mëshqerra". Gjatë takimit, ku ishte i pranishëm edhe drejtori i Bujqësisë, Vezir Januzi, u bisedua për mundësitë e bashkëpunimit në realizimin e

projekteve të bujqësisë. Nën kryetari Rudari ka shprehur gatishmërinë për mbështetjen e këtij sektori dhe ka thënë se "bashkëpunimin

do ta kurorëzojmë me nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi, për mbështetjen e fermerëve llapjanë".



Përpyjekje për politizim dhe përfitime politike nga vjedhja e parasë publike!



Reagim i KMDLNJ-së

Kohë më parë një inspektor i Komunës së Prishtinës u arrestua pasi u kap në flagrancë duke marrë 12 000 euro nga pala e dëmtuar. Menjëherë pas kësaj pati reagime të shumta, më pak për shkak të veprës korruptive e më shumë me akuza se inspektor i arrestuar qenka anëtar i LV-së. Në vend se të pritët që hetimet të përfundojnë dhe drejtësia të ndajë dënimin pas shqyrtimit të provave, deklaratat ishin më shumë të natyrës politike dhe kërkohet përgjegjësi nga LV-ja thuaja se vepra penale e korrupsionit qenka bërë me urdhër të partisë dhe se ato 12 000 euro janë derdhur në llogarinë e LV-së. Pastaj, ndodhi edhe një hajni shumë më e madhe kur nga Thesari, pa autorizim dhe në mënyrë

të kundërligjshme nga një i punësuar aty, në llogari të një ndërmarrje private u derdhën 2.1 milionë euro. Ende pa filluar hetimet dhe pa u shqiptuar asnjë masë ndaj L.G që e bëri këtë transfer, nisi lufta politike dhe partiake: i arrestuari qenka anëtar i PDK-së, kurse nga ana tjetër kishte akuza se familja Gruda tradicionalisht kanë mbështetur LDK-në. Në anën tjetër, K.Sh që gjendet në arrati qenka anëtar i Nismës, dhe në vend se të konsiderohet si akt kriminal vjedhja e 2.1 milionë eurove po bëhen përpyjekje që përmes politizimit të këtij akti kriminal të përfitohet politikisht. Në këtë kontekst pati deklarime të forta por krejtësisht të panevojshme të liderëve politikë dhe distancime publike. Madje, një zëvendës kryeministre,

duke e injoruar faktin se përgjegjësia është individuale dhe se nuk mund të ketë hakmarrje kolektive e largoi nga puna një këshilltare politike për faktin se babai i saj paska përfituar nga kjo vjedhje e 2.1 milionë eurove, pa përfunduar hetimet dhe pa u dëshmuar fajësia apo pjesëmarrja e këshilltares së saj në këtë veprë kriminale. Pastaj u kërkua dorëheqja e ministres së Financave, znj. Hykmete Bajrami ndonëse kjo, sipas KMDLNJ-së nuk ka asnjë përgjegjësi, as të drejtpërdrejtë e as të tërthortë. Edhe këtu vjen në shprehje përpyjekja për përfitim politikë andaj pa asnjë të drejtë kërkohet koka politike e ministres Bajrami. Madje u kërkua edhe përgjegjësia e Zafir Berishës gjithashtu pa asnjë të drejtë, sigurisht për qëllime politike.

Nuk ka asnjë dëshmi se prapa aktit korruptiv ku u morën 12 mijë euro qëndron LV-ja e gjithashtu nuk ka asnjë dëshmi se prapa vjedhjes së 2.1 milionë eurove qëndrojnë PDK-ja, LDK-ja apo Nisma, andaj të gjithë duhet të përmbahen nga deklarimet e papërgjegjshme apo politizimit të akteve ekskluzivisht kriminale dhe për përfitime personale e jo partiake dhe të presin përfundimin e hetimeve. Përpyjekja për politizim të këtyre akteve të vjedhjeve janë presion mbi hetuesinë, pengojnë hetimet dhe ndërhyrje në procesin eventual gjyqësor dhe gjithashtu në marrjen e një vendimi të drejtë të gjykatës kompetente. Për KMDLNJ-në është krejtësisht e papranueshme që, ende pa përfunduar hetimet dhe pa një vendim të formës së prerë të

caktohet përgjegjësia dhe në këtë mënyrë i shkelën të drejtat e njeriut edhe të të dyshuarve e sidomos personave që kanë poste publike dhe institucionale të cilëve, në pamundësi t'iu dëshmohet fajësia, përmes linçimit publik u shqiptohet dënimi sikur që po bëhen përpyjekje ndaj ministres Bajrami, Zafir Berishës, LV-së, PDK-së, LDK-së dhe Nismës. Për KMDLNJ-në është shumë e rëndë vjedhja e arkës 300 kg në Agjencionin e Ushqimit dhe Veterinës, pavarësisht deklarime se aty nuk kishte shuma të mëdha të parave e që tregon qartë se nuk kanë qenë qëllimi paratë por dokumentacioni. Parimi i përgjegjësive individuale duhet të respektohet deri në fund sikur edhe parimi i prezumimit të pafajësisë siç bëhet në çdo shtet ligjor.

Komuna e Mitrovicës organizon aktivitet simbolik në muajin kundër kancerit të gjirit

MITROVICË, 23 TETOR (ER) - Me iniciativën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe në bashkëpunim me Zyrën për Barazi Gjinore si dhe OJQ "Mundësia", të premtën është mbajtur një aktivitet simbolik në sheshin e qytetit "Mehë Uka" në shenjë sensibilizimi dhe vetëdijesimi të luftës kundër kancerit të gjirit. Në këtë aktivitet morën pjesë kryetari i komunës, Agim Bahtiri, drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj Barani, drejtoresha e Administratës, Valmire Sylejmani, zyrtarja komunale për Barazi Gjinore, Besa Veseli, drejtoresha e OJQ "Mundësia", Hasime Tahiri-Hasani, asambleiste, zyrtare nga policia, si dhe një numër i konsiderueshëm i grave, vajzave dhe të interesuarve të tjerë. Me këtë rast, kryetari Bahtiri ka potencuar se institucionet lokale në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile në vazhdimësi kanë organizuar aktivitete dhe ligjëratat të ndryshme për t'i vetëdijësuar gratë lidhur me praninë e kësaj sëmundjeje, trajtimin dhe zbulimin hershëm të kësaj sëmundjeje. Prioritet i komunës sonë është dhe do të jetë shëndeti i qytetarëve, me theks të



veçantë shëndeti i nënave, motrave dhe vajzave tona. Ndërsa drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj Barani, ka theksuar se interesimi i madh për pjesëmarrje dhe informim tregon vetëdijesimin e krijuar nga qytetarët e komunës sonë dhe se zbulimi i hershëm i kësaj sëmundjeje ndihmon në trajtimin më të lehtë. Gjithashtu, ajo inkurajoi gratë që vazhdimisht të bëjnë kontrolle ultrasonografike dhe monografike. Përveç shpërndarjes së fletushkave informuese dhe maskave, në kuadër të këtij aktiviteti disa grave nga fshatrat Lipë, Bistricë, Bajgorë dhe Vllahi iu është mundësuar nga Drejtoria e Shëndetësisë kryerja e shërbimeve monografike në QKMF-në "Dr. Nexhat Çuni" deri në fund të vitit falas dhe për të gjithë qytetarët kontrollet falas.

Haziri fton qytetarët t'i respektojnë masat kundër Covid-19

PRISHTINË, 23 TETOR (ER) - Pas rikthimit të infeksionit në Gjilan, kryetari i kësaj komune, Lutfi Haziri, ka ftuar qytetarët t'i mbajnë maskat në rrugë, lokale e në punë, në mënyrë që t'i evitojnë gjokat dhe t'i kthehen solidaritetit e lojalitetit. Këto komente kreu i Gjilanit i ka bërë në një konferencë për media, pas takimit të komitetit për parandalimin e përhapjes së Covid-19. "Gjilani ka realizuar 4 200 teste në këtë fazë pandemie dhe deri sot janë 48 të vdekur nga Covid-19, 165 raste janë aktive dhe nën mbikëqyrje nga institucionet tona. 1 229 janë të infektuar në total, 1 015 të shëruar, 12 raste janë në hospitalizim dhe 178 mostra janë në pritje për rezultat", ka thënë Haziri teksa ka njoftuar se pas disa rasteve pozitive në shkolla, nuk ka vend për shqetësim. Ai ka thënë se po punojnë bashkërisht

me të gjitha institucionet relevante që ta ulin infeksionin në pikën zero. Ndërkaq drejtori i Arsimit në Gjilan, Nazim Gagica, ka njoftuar se për momentin janë të infektuar 12 nxënës, 13 mësime dhe 3 punëtorë teknikë në shkollat publike. "Rastet janë në monitorim të vazhdueshme nga ana e task-forcës së DKA-së. Tashmë të gjitha shkollat e kanë urdhëresën për respektim të masave nga ana e shkollave. Lajmi i mirë është që në 75 për qind të shkollave nuk ka infeksion me Covid-19", ka thënë Gagica. Mesazhe për respektimin e masave anti-Covid-19 kanë dhënë edhe drejtori klinik i Spitalit të Përgjithshëm, dr. Ukshin Ismaili, drejtoresha e Qendrës Rajonale të Shëndetit Publik, dr. Ajhane Sefiu dhe drejtoresha e QKMF në Gjilan, dr. Arbenita Hajdari.





SHTATË LAJMËSIT

Nga: Dino BUZZATI
Përktheu: Rezar DIZDARI

I nisur për të eksploruar mbretërinë e tim eti, për ditë e ma shumë largohem prej qytetit e lajmet prej atje më mbërrijnë gjithnji e ma të ralla.

Kam fillu udhëtimin pak ma shumë së tridhjetë vjeçar e kanë kalu ma shumë se tetë vite, saktësisht tetë vite, gjashtë muaj e trembëdhjetë ditë ecje të pandërprerë. Kur u nisa besoja se në pak javë do të kisha arritë kollaj në kufinj të mbretërisë, porse kam vazhdu të takoj gjithmonë njerëz e vende të reja; e gjithkund njerëz që flasin gjuhën time, që thonin se janë nënshtetas të mi.

Mendoj nganjëherë se busulla e geografit tim është çmendë dhe se, duke kujtu se drejtohem kah jugu, ne në fakt jemi sjellë rreth vehtes, pa e rritë kurrë largësinë prej kryeqytetit; kjo mund të shpjegojë arsyen përse nuk kemi arritë ende në kufirin fundor.

Por ma shpesh më mundon dyshimi se ky kufi nuk ekziston, se mbretëria shtrihet pa asnjë kufi dhe se, edhe pse unë shkoj përpara, kurrë nuk mund të mbërrij deri në fund.

Fillova rugëtimin kur isha ma shumë se tridhjetë vjeç, shumë vonë ndoshta. Miqtë e të afërmit talleshin me projektin tim si një harxhim i kotë i viteve ma të mira të jetës. Realisht pak prej të besuarve të mi e mundësuan nisjen.

Edhe pse moskokëçarës – edhe ma shumë se tashit! – e kisha merak që të komunikoj gjatë udhëtimit, me të dashtunit e mi, e ndër kalorësit e shoqërimin zgjodha shtatë ma të mirët, që të më shërbenin si lajmësa.

Besoja, pa e ditur, se të kisha shtatë ishte një tepri. Me kalimin e kohës e

kuptova se përkundrazi ishin krejt pak; edhe pse asnjëri prej tyre as nuk është sëmurrur, as nuk ka has ndër cuba, as nuk ka prishë takëmet e kalit. Që të shtatët më kanë shërby me një këmbëngulje e përkushtim që zorë se do të mund t'ua shpërblej ndonjëherë.

Për t'i dallu kolaj i vura emrat e tyre me gërmën e parë simbas rendit albetik: Alesandro, Bartolomeo, Caio, Domeniko, Ettore, Federiko, Gregorio.

I pa mësuar larg shpisë, nisa Alesandron, qysh mbrëmjen e ditës së dytë të udhëtimit, kur kishim përshku nja tetëdhjetë lega. Mbrëmjen tjetër, për me siguru vazhdimësinë e komunikimeve, nisa të dytin, mandej të tretin, mandej të katërtin, njërin pas tjetrit, deri mbrëmjen e tetë, kur u nis Gregorio. I pari nuk ishte kthy ende. Na u bashkua natën e dhjetë, teksa po përgatisnim fushimin për natën, në një luginë të pabanuar. Mësova nga Alesandro se shpejtësia e tij kishte qënë nën pritshmërinë; kisha menduar se, duke kalëruar vetëm, me një kalë lufte të mirë fort, ai do të mund të përshkruante, në të njëjtën kohë, një distancë sa dy herë e jona; porse ai kishte mbërrit vetëm tek një herë e gjysma: në një ditë, teksa ne përparonim dyzetë lega, ai bluante gjashtëdhjetë, po jo ma shumë.

Kështu qe edhe me të tjerët. Bartolomeo që u nisur për në qytet mbrëmjen e tretë të udhëtimit, na mbërriti të pesëmbëdhjetën; Kaio që u nis të katërtën, vetëm në të njëzetën u kthye. Shpejt vura re se mjaftonte të shumëzoja me pesë ditët e harxhuara për të mbërritur deri atje për me gjetë se kur do të na kapte lajmësi.

Duke u larguar edhe ma tepër prej kryeqytetit rrugëtimi i lajmësve bëhej gjithnji e ma i gjatë. Mbas dyzetë ditë ecjeje, intervali ndërmjet një arritjeje të lajmësve dhe tjetrës nisi e u zmadhu ndijshëm; ndërsa

më parë shihja të mbërrinte në kamp një në çdo pesë ditë, ky interval u bë njëzetepesë; zëri i qytetit tim vinte e bëhej gjithnji e më i mekur; kalonin javë të tëra pa pasë asnji njoftim.

Mbasi kaluan gjashtë muaj – kishim kapërcyer malet Fazani – intervali ndërmjet një mbaritjeje dhe tjetrës së lajmësve shkoi në plot katër muaj. Ata më sillnin tashma lajme të kahershme; zarfat më arrinin të zhubravitur, herëherë me njolla lagështie prej netëve të kaluara përjashta të atyre që i kishin me vete.

Vazhduam më tej. Më kot përpiqësia të bindja veten se retë që lundronin mbi mua ishin njëllor si ato të fëmijërisë sime, se qielli i qytetit të largët nuk ishte i ndryshëm prej kupolës së kaltër sipër meje, se ajri ishte i njëjti, po ai filladi i erës. Retë, qielli, ajri, erërat, zogjtë, në të vërtetë më dukeshin të reja e të ndryshme; e unë ndihesha i huaj.

Ec, përpara! Endacakët e hasur fushave më thonin që kufinj të nuk ishin larg. Unë i shtyja njerëzit i mi të mos ndaleshin, shuaja shënjat e ligështimit që formoheshin mbi buzët e tyre. Kishin kaluar katër vite që prej nisjes sime: çfarë lodhjeje e tejzgatur. Pasuria, shpia ime, ishin bërë çuditërisht të largëta, gati nuk e besoja. Plot njëzetë muaj heshtje e vetmi kalonin tani ndërmjet çfaqjeve të njëpasnjëshme të lajmësave. Më sillnin letra të çuditëshme të zverdhura nga koha, e në to gjeja emra të harruar, mënyra thëniejeje të pazakonta për mua, ndjesi që nuk arrija t'i kuptoja. Mëngjesin tjetër, pas vetëm një nate pushim, teksa ne rifillonim rrugëtimin, lajmësi nisej në drejtim të kundërt, duke çuar në qytet letrat që unë prej kohësh kisha përgatitur.

Por kanë kaluar tetë vite e gjysëm. Sonte po darkoja vetëm në çadrën

time kur hyri Domeniko, i cili arrinte ende të buzëqeshte edhe pse i përdredhun prej lodhjes. Prej shtatë vitësh nuk e shihja. Për gjithë këtë kohë të gjatë ai nuk kishte bërë tjetër veçse kishte kalëruar, përmes livadhesh, pyjesh e shketëtirash, duke ndërruar kushedi sa herë kuajt, për të më sjellë këtë pako zarfash që unë deri më tash nuk kam pas dëshirë me i hapë. Ai ka shku me fjetë tashma e do të riniset nesër në agim.

Tek blloku i shënimeve ka llogaritur që, nëse gjithçka do të shkojë mirë, unë duke vazhduar ecjen time siç kam bërë deri më tash e ai të tijën, mund ta shoh Domenikon vetëm pas tridhjetekatër vitësh. Por kam filluar të ndihem i lodhur dhe mundet që vdekja të më arrijë përpara. Kështu nuk do mund ta shoh më.

Pas tridhjetekatër vitësh (përpara madje, shumë më përpara) Domeniko do të dallojë papritmas zjarret e fushimit tim dhe do të pyesë vetëm përse vallë, unë ndërkohë kam ecur kaq pak. Ashtu si sonte, lajmësi i mirë do të hyjë në çadrën time me letrat e zverdhura prej viteve, plot me lajme absurde të një kohe të varrosur tashma; por do të shtangë tek pragu, duke më parë të palëvizur shtrirë përmbi shtroje. E hajt pra nisu, Domeniko, e mos thuaj se jam mizor! Çoje përshëndetjen time të fundit në qytetin ku kam lindur. Ti je lidhja e mbijetuar me botën që një herë e një kohë ishte edhe imja. Lajmet ma të fundit më kanë bërë me dije se shumë gjëra kanë ndryshuar, që babai im ka vdekur, që Kurora i ka kaluar vëllait tim të madh, që më dijnë për të humbur, që kanë ndërtuar pallate të tjera guri aty ku më përpara ishin lisat nën të cilëve unë shkoja e luaja. Por është gjithmonë atdheu im i vjetër.

Ti je lidhja e fundit me ta, Domeniko. Lajmëtar i pestë, Ettore,

që do të na mbërrijë, ndashtë Zoti, pas një viti e tetë muajsh, nuk do të mund të riniset më sepse nuk do ketë kohë të kthehet. Mbas teje heshje, o Domeniko, të paktën nëqoftëse unë ma në fund nuk do kem gjetë kufinj të shumëpritur. Por sa shkon, e më shumë bindem se nuk ekziston kufi.

Nuk ekziston, kam dyshim unë, të paktën në kuptimin që ne jemi mësuar t'i mendojmë. Nuk ka mure të mëdhenj ndarjeje, as lugina ndarëse, as male që e mbyllin shtegun. Ndoshta do ta kapërcej kufirin pa e marrë as vesh, e do të vazhdoj të shkoj përparë, pa e ditë. Prandaj unë them se Ettore e lajmësat e tjerë mbas tij, kur të na kenë mbërritur përsëri, nuk do të rimarrin më rrugën e kryeqytetit por do nisen përpara e të më paraprijnë, në mënyrë që unë të mund të di që më përpara së çfarë më pret.

Një ankth i pazakontë më përndizet mbramjeve, e nuk është keqardhja për gëzimet e lëna pas, siç ndodhte në fillim të udhëtimit; më së shumti është padurimi për të njohur tokat e panjohura për kah po drejtohem.

Vërej se – e nuk ia kam thënë kurrkujt deri më tash – vërej se si ditë mbas dite, teksa përparoj drejt vendmbërritjes së paarrtëshme në qiell rezaton një dritë e pazakontë që nuk më është çfaqur kurrë, as ndër andrra; se si bimët, malet, lumenjtë që kapërcejmë, duken si të përbëra nga një esencë tjetër nga ajo e jona dhe ajri ndjell shënja paralajmëruese që nuk di se si tua vë emrin.

Një shpresë e re do të më tërheqë nesër në mëngjes edhe ma përpara, drejt këtyre maleve të paeksploruara që hijet e natës po i fshehin. Prapë unë do të ngrë fushimin, ndërsa Domeniko do të zhduket në horizont nga ana e kundërt, për të më çuar në qytetin e largët mesazhin tim të kotë.

William Faulkner: Një fjalë për shkrimtarët e rinj

Dy vjet më parë Presidenti Eisenhower konceptoi një plan të mbështetur në një ide e cila në thelb është e mirë. Ideja ishte se rrethanat botërore, dilemat universale të njerëzimit në këtë kohë, janë ato që janë, thjesht dhe vetëm sepse burra dhe gra, individë të racave, gjuhëve dhe kushteve të ndryshme shoqërore s'mund t'i diskutojnë me njëri-tjetrin këto probleme dhe dilema që janë më së shumti të tyre, por duhet të përpiqen të bëjnë vetëm përmes organizatave zyrtare të qeverive të tyre kundërshtarë dhe siç duket të papajtueshme

Kjo do të thotë, që individëve në të gjitha sferat e jetës duhet t'u jepet mundësia të flasin me individët në kampin e kundërt kudo në tokë – punëtori me punëtorin, shkencëtari me shkencëtarin, mjekët, avokatët, tregtarët, bankierët dhe artistët me kolegët e tyre që kanë pikëpamje të kundërta, kudo.

Agjë të gabuar s'ka tek kjo ide. Padyshim që asnjë artist – piktor, muzikant, skulptor, arkitekt, shkrimtar – s'do ta kundërshtonte sepse kjo – përpjekja e njeriut për të komunikuar me njeriun pavarësisht nga raca, ngjyra ose gjendja shoqërore – është pikërisht ajo që çdo artist është rrekur ta bëjë tashmë gjatë gjithë jetës, dhe do të vazhdojë ta bëjë derisa të marrë frymë.


Ajo çfarë e ka penguar këtë shenjohet nga frazeologjia e konceptit të vetë Presidentit: punëtor me punëtor, artist me artist, bankier me bankier, manjat me manjat. Çfarë e ka penguar këtë për mendimin tim ishte një e keqe e qenësishme tek vetë kultura jonë; një cilësi e keqe e qenësishme (dhe mbase e domosdoshme edhe pse s'e besoj këtë të fundit) në kulturën e çdo vendi të aftë të durojë dhe mbijetojë gjatë kësaj periudhe të historisë. Ky është besimi mistik, gati fetar, që njeriu si individ s'mund të flasë me njeriun tjetër si individ, sepse individ s'mund të ekzistojë më. Një besim se s'ka më një vend ku individ mund t'i flasë me qetësi individit tjetër për gjëra të tilla të thjeshta si ndershmëria me veten dhe përgjegjësia ndaj të tjerëve, mbrojtja e të dobëve, dhembshuria dhe keqardhja për të gjithë, sepse gjëra të tilla individuale si ndershmëria, keqardhja, përgjegjësia dhe dhembshuria s'ekzistojnë më dhe vetë njeriu mund të shpresojë të vazhdojë vetëm po hoqi dorë dhe mohoi individualitetin duke u bërë pjesë e një grupi të veçuar në mënyrë arbitrare, dhe të organizuar si regjim, i cili pozicionohet kundër një grupi tjetër të veçuar në mënyrë arbitrare, i organizuar si regjim, të dy duke mbushur të njëjtën atmosferë dhe në të njëjtën kohë me abstragime të dykuptimshme si "demokraci e popujve", "të drejtat e pakicave", "drejtësi e barabartë" dhe "mirëqenie

sociale" – të gjitha sinonimet që heqin turpin nga papërgjegjësia duke mos ftuar por madje duke i detyruar të gjithë të bëhen pjesë e saj.

Pra, në këtë rast – dua të them se ashtu si popullit – edhe artistit, i cili tashmë e ka kaluar jetën duke u përpjekur t'u kumtoj për njeriun – problemet dhe pasionet e zemrës njerëzore, si të mbijetojmë ose gjithsesi t'i durojmë ato, i është kërkuar nga Presidenti i vendit për të pohuar atë mitologji të cilës ia ka kushtuar tashmë jetën duke e mohuar: mitologjia se një njeri i vetëm s'është asgjë, dhe mund të ketë peshë dhe thelb vetëm kur organizohet brenda anonimatit të një grupi ku ai ia dorëzon shpirtin e tij individual duke u kthyer në numër.

Do të ishte vërtetë e trishtueshme nëse vetëm në momente të tilla si kjo – dua të them, pranimi zyrtar nga vendi të cilit i përket i vlerës së përkushtimit jetësor të artistit – artistit t'i duhej të kalonte me të gjitha energjitë e tij në atë që mund të quhet gati një vullnet universal për organizim ushtarak, një vullnet universal për të zhdukur njerëzoren nga njeriu edhe në masën e çlirimit të tij jo vetëm nga përgjegjësia morale, por edhe nga dhimbja fizike dhe vdekshmëria duke e shndërruar atë individualisht në çdokënd tjetër, s'ka rëndësi në cilin, për sa kohë që është zhdukur si pjesë e njërit prej tyre, duke u bërë pjesë e një grupi të njohur kombëtar ekonomik nga profesioni, tregtia ose profesioni ose në niveli të tatimit mbi të ardhurat ose, nëse s'ofron asgjë tjetër, duke u kthyer në numër në një listë të ndërmarrjeve financiare. Tragjedia e tij është se sot ai duhet ta luftojë këtë trysni, të humb një pjesë të vetes, dhe nëse është artist, i duhet një forcë e shumë e madhe individuale kundër këtij vullneti universal për ta fshirë humanitetin e tij individual, që të jetë artist. Dhe kjo na shpie më në fund tek ideja që dua të sugjeroj, e cila më duket se është një dilemë që e kanë të gjithë shkrimtarët e rinj sot.

Mendoj se ndoshta të gjithë shkrimtarët, ndërsa janë "të nxehtë", duke punuar me shpejtësinë më të madhe pasi ndiejnë nevojën e jashtëzakonshme për të thënë



diçka, s'i lexojnë shkrimtarët më të rinj, ata që shkruajnë më pas, ndoshta për të njëjtën arsye që vrapuesi i garave të shpejta apo të gjata s'ka kohë të interesohet se kush është pas tij apo edhe edhe ngjitur me të, por vetëm të shoh kë ka përpara. Kjo ishte e vërtetë në rastin tim të paktën, kështu që kishte një zbrazëti prej rreth njëzet e pesë vjetësh gjatë së cilës s'kisha pothuajse asnjë njohuri për letërsinë bashkëkohore.

Kështu, kur pak kohë më parë fillova të lexoja letërsinë që shkruhet tani, e bëra jo vetëm me mosdije, por edhe një lloj pafajësie, freskie, atë që mund ta quani pikëpamje dhe interes të dëlirë, pa paramendime. Sidoqoftë, përshtypja që mora nga historia e parë që lexova më është përsëritur kaq shpesh qysh atëherë, sa do ta paraqes si përgjithësim.

Kjo do të thotë se shkrimtari i ri i sotëm, për shkak të gjendjes së tashme të kulturës sonë të cilën u përpoqa ta përshkruaj, është i detyruar të punojë në një lloj zbrazëtie të racës njerëzore. Personazhet e tij nuk jetojnë, marrin frymë, luftojnë, në atë sprovë dhe zemëratë të humanitetit të thjeshtë, si të paraardhësve që ishin mjeshtrat nga të cilët mësuam zanatin tonë: Dickens, Fielding, Thackeray, Conrad, Twain, Smollett, Hawthorne, Melville, James; ata kanë legjione personazhesh që jo vetëm u mëkuan, por edhe u rritën në gjirin e sprovës dhe zemëratës së qenieve të thjeshta njerëzore, ekzistenca e të cilëve ishte pohim i një optimizmi të pashërueshëm dhe të paepur – të burrave dhe grave si ata vetë, të kuptueshëm dhe të rrokshëm edhe kur ishin antipatik, madje

edhe në çastin kur ata po vrisnin, plaçkitnin ose po tradhtonin, pasi kishin të njëjtat epshe të thjeshta njerëzore, shpresë dhe frikë të pandërlikuar nga organizimi shoqëror si regjiment ushtarak apo detyrimi i grupit – sprovë dhe zemëratë e njerëzores prej të cilës mund të gjenin shtetgdalje jo vetëm të pafrikësuar por edhe me kënaqësi dhe pa kërcënimin e të lënduarit pasi më e keqja që mund t'u ndodhte do të ishte një kokë e përplasur me një tjetër kokë njeriu, një bërryl ose një gu që të lëndon por sidoqoftë ishte gu ose bërryl tjetër njeriu që e bënte këtë – sprovë dhe zemëratë e njerëzimit që pranoi dhe besoi dhe funksionoi, jo sipas pikëpamjeve, por sipas parimeve morale; ku e vërteta nuk ishte aty ku ti po qëndroje, nga po e shihje, por ishte një cilësi ose diçka e pandryshueshme që mund dhe të rrezonte përtokë nëse s'e pranoje ose të paktën ta respektoje.



Ndërsa sot personazhet e shkrimtarit të ri janë të detyruar të mos funksionojnë me individualitet, por në izolim, s'ndjekin shoqërinë e pafund të anktheve dhe shpresave të të gjitha zemrave njerëzore në botë të mburjtura me disa të vërteta të thjeshta, të kuptueshme dhe parime morale, por ekzistojnë vetëm brenda një zbrazëtie faktesh të cilat ai s'i zgjodhi dhe s'mund t'i përballojë dhe prej të cilave s'mund të arratiset njësoj si insekti brenda një kupe të përmbysur.

Më lejoni ta përsëris: s'i kam lexuar të gjitha veprat që brezi i sotëm ka shkruar; ende s'kam pasur kohë. Kështu që duhet të flas vetëm për ato vepra që i njoh. Tani po mendoj për atë që vlerësoj më të mirin: Rojë në thekërishten

buzë gremenës, mbase sepse ky roman shpreh plotësisht atë që po rrekem të them: një i ri, ati i asaj që do, duhet që një ditë të jetë burrë, më inteligjent se disa dhe më i ndjeshëm se shumica, (ai as s'do ta quante instiktivisht sepse s'e e dinte që e zotëronte) një burrë i cili ngaqë Zoti mbase e kishte vendosur atje, e donte burrin dhe dëshironte të ishte pjesë e njerëzimit, një burrë i cili u përpoq t'i bashkohej racës njerëzore dhe dështoi. Për mua, tragjedia e tij është jo se ishte, siç mbase mendonte, jo i fortë ose trim sa duhej apo se s'e meritonte të pranohej si pjesë e humanitetit. Tragjedia e tij ishte se kur u përpoq të hynte në racën njerëzore, s'kishte asnjë racë njerëzore atje. S'kishte asgjë për të përveç gumëzhimës shurdhuese dhe të pandryshueshme brenda mureve prej qelqi të kupës së tij derisa të hiqte dorë ose të shkatërrohej vetë nga gumëzhitja shurdhuese, shkatërruese brenda tij. Sigurisht, mendja të shkon menjëherë tek Huck Finn, një tjetër i ri tashmë baba i asaj që një ditë së shpejti do të bëhet burrë. Por në rastin e Huck-ut gjithçka ndaj së cilës ai duhej të luftonte ishte përmasa e tij e vogël, të cilën koha do t'ia gjente ilaçin; me kalimin e kohës do të rritet si çdo njeri me të cilin duhej të përballlej; dhe madje ashtu siç ishte, gjithçka që bota e të rriturve mund të bënte për ta dëmtuar atë ishte t'ia tërhiqte pak hundën; humaniteti, raca njerëzore, po e pranonte tashmë dhe do ta pranonte; gjithçka që duhej të bënte ishte vetëm të rritej në të.

Kjo është dilema e shkrimtarit të ri siç e shoh unë. Jo vetëm e tij, por të gjitha problemet tona, janë për të shpëtuar njerëzimin që të mos çshpirtërohet ashtu si tredhet hamshori, derri i egër apo demi; për ta shpëtuar individin nga anonimati para se të jetë tepër vonë dhe njerëzorja të jetë zhdukur nga kafsha e quajtur njeri. E kush mund ta shpëtojë njerëzoren e njeriut më mirë sesa shkrimtari, poeti, artisti, pasi kush më shumë duhet t'i frikësohet humbjes së tij sepse njerëzorja e njeriut është lëngu i jetës së artistit.

*Fjalim i mbajtur në Universitetin e Virxhinias, 1958
Përktheu: Granit Zela*



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
 'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82**

Distria Krasniqi e fitoi medaljen e artë në Budapest

Khudoja e Kosovës regjistroi suksesin e parë pas rikthimit të garave, pas një ndalesë të gjatë për shkak të pandemisë Covid-19. Distria Krasniqi e fitoi në Hungari medaljen e artë, kurse në garë për medalje janë edhe Akil Gjakova, Laura Fazliu dhe Loriana Kuka

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

BUDAPEST, 23 TETOR - Xhudistja pejane Distria Krasniqi e ka fituar medaljen e artë në "Grand Slam-in" e Hungarisë. Rrethin e parë Krasniqi e kaloi pa luftë, kurse në atë të dytin ishte më e mirë se hungarezja Eva Csernoviczki. Në rrethin e tretë Distria Krasniqi e mposhti francezen Shirine Boukli, ndërsa në gjysmëfinale Krasniqi e mposhti izraeliten Shira Rishony, ndërsa në finalen e madhe

Krasniqi e mposhti argjentinase Paula Pareto dhe në këtë mënyrë e rrëmbeu medaljen e artë. "E arta e Disit po vjen në Kosovë! Finale e bukur e mjeshtërore kundër kampiones aktuale olimpike, Pareto Paula. 1 000 pikë olimpike. Kosova mbi të gjitha...", ka thënë trajneri Driton Kuka pas triumfit të Distria Krasniqit. Flaka Loxha dhe Shigeki Nakamura u ndalën në raundin e dytë. Loxha (-57 kg) shënoi një fitore për t'u mposhtur më pas nga favoritja me përvojë të madhe

Jessica Klimkeit e Kanadasë. Nakamura (-66 kg) u ndal nga kampioni i Evropës 208, sloveni Adrian Gomboc. Ndërkohë, Nora Gjakova (-57 kg) u mposht në raundin e dytë nga francezja Helene Receveaux. Sot (e shtunë) garojnë Akil Gjakova (-73 kg) dhe Laura Fazliu (-63 kg), ndërsa Loriana Kuka (-78 kg), garon të dielën. Kosova në këtë garë prestigjioze po përfaqësohet me 7 garues, kurse pjesëmarrës janë afër 500 garues nga rreth 70 shtete të botës.



Ramadani shpall listën për ndeshjet me Malin e Zi dhe Suedinë

PRISHTINË, 23 TETOR - Përzgjedhësi i Kosovës në hendboll, Taip Ramadani, ka shpallur të premtën listën e lojtarëve për ndeshjet me Malin e Zi dhe Suedinë. Janë këto ndeshjet e para të raundit të dytë kualifikues për Euro 2022. Kosova me Malin e Zi luan në Podgoricë më 4 nëntor, kurse më 8 nëntor e presim Suedinë në Prishtinë. Ramadani për këto dy ndeshje ka llogaritur kryesisht në lojtarë të konfirmuar. 11 prej tyre janë klube të Kosovës. Nga pesë



lojtarë në Kombëtare i kanë Besa Fingas e Prishtina, kurse për herë të parë është ftuar Festim Mustafa i Kastriotit, ish-lojtar i Kombëtares U21. Për herë të parë është ftuar edhe Armend Alaj që bën karrierë në Bundesliga 2 të Gjermanisë. Në Zvicër bëjnë karrierë katër lojtarë të ftuar, duke përfshirë kapitenin Valon Dedaj që po kalon formë të lartë. Ndërkohë në Suedi

luajnë tre lojtarë që janë në listën e Ramadani. Portieri Liridon Zena vjen nga kampionati kroat. Për shkak të situatës me koronavirus, selektori Ramadani e ka të pamundur të udhëtojë nga Australia për këtë grumbullim. Kryetrajner për këto dy ndeshje është emëruar spanjulli Javier Cabanas që për ndihmës i ka Arben Muqollin e Veton Hajrizin.

Sot zhvillohen tri ndeshje, nesër dy

PRISHTINË, 23 TETOR - Në kuadër të javës së tetë në Superligën e Kosovës në futboll sot (e shtunë) do të zhvillohen tri ndeshje. Kampionia në fuqi, Drita, në përballje me Drenicën, do të përpiqet ta harrojë humbjen e pësuar nga Ballkani dhe t'u rikthehet fitoreve. Fitoren e parë në këtë kampionat e kërkon edhe Llapi i Tahir Batatinës, që ka një fillim jashtëzakonisht negativ sa iu përket rezultateve. Përballë Llapit do të jetë skuadra në topformë e Arbërisë, e cila në sezonin e parë në Superligë ka treguar qëndrueshmëri duke u pozicionuar pas shtatë xhirove në pjesën e epërme të tabelës. Për fitore do të luajë edhe Feronikeli i Klodian Duros ndaj Besës së Pejës. Nesër (e diel) zhvillohen dy përballjet e tjera ku takohen: Prishtina - Gjilani dhe Trepça '89 - Ballkani.



SUPERLIGA

Të shtunën takohen:
 Drita - Drenica
 Llapi - Arbëria
 Besa - Feronikeli

Të dielën takohen:
 Prishtina - Gjilani
 Trepça '89 - Ballkani

Donjeta Sadiku kualifikohet në finale

PRISHTINË, 23 TETOR - Donjeta Sadiku është kualifikuar në finale të turneut ndërkombëtar "Balkan", që po mbahet në Botevgrad të

Bullgarisë. Donjeta në gjysmëfinale mposhti boksieren vendase Mehmedova Aslahan, kategoria -60 kilogramë. Në

finalen që zhvillohet sot (e shtunë), boksierja nga Kosova takohet me kampionen e botës, brazilianen Beatriz Ferreira, e cila në renditjen më

të re të AIBA-s, ndodhet në vendin e parë. Drejtësinë në këtë turne po e ndan edhe gjyqtari ynë ndërkombëtar, Latif Demolli.



Kumbulla debutoi me gol në Ligën e Evropës: Golin ia dedikoj skuadrës

ROMË, 23 TETOR - Mbrojtësi shqiptar Marash Kumbulla debutoi në mënyrën më të mirë në Ligën e Evropës duke i dhënë fitore Romës 2-1 ndaj Young Boysit, me një gol me kokë. Duke folur pas ndeshjes për

"Sky Sport", mbrojtësi i Kombëtares kuqezi tregoi emocionet e tij. "Një debutim i pabesueshëm, por më të bukur e bëri fitorja. Jam shumë i kënaqur që shënova dhe i dhashë ekipit tri pikë.

Kundërshtari na bëri presing lart dhe na vuri në vështirësi në organizimin e lojës, por në pjesën e dytë ndryshuam dhe krijuam shumë më tepër. Besoj se e merituam plotësisht fitoren. Përshatja e shpejtë te Roma?

Kjo falë trajnerit, stafit të tij e të gjithë skuadrës, që më kanë pritur mjaft mirë në dhomat e zhveshjes dhe më kanë bërë pjesë të lojës së ekipit. Golin ia dedikoj skuadrës", ka deklaruar Kumbulla.



Sot e gjithë vëmendja kah 'El Clasico'

BARCELONË, 23 TETOR - Sot (e shtunë), me fillim nga ora 16:00, në "Camp Nou", Barcelona e pret Real Madridin në kuadër të "El Clasico"-s. Reali në këtë ndeshje hyn pas dy humbjeve radhazi, në La Liga nga Cadizi dhe në Ligën e Kampionëve nga Shakhtari. I pyetur në lidhje me momentin e keq të Real Madridit, trajneri i Barcelonës, Ronald Koeman, është shprehur: "Është e çuditshme të mos kesh tifozë për ta krijuar atmosferën. Ndoshta Real Madridi nuk ishte në nivelin e tyre. Kjo do të thotë se ata vijnë me një nivel të ulët. Ata dinë të përballojnë këtë presion. Nuk mendoj se ky moment do të ketë ndikim. Ju mësoni dhe rrisni besimin tuaj nëse fitoni ndeshjet. Lojtarët e meritojnë atë për punën që janë duke e bërë çdo ditë. Ata tregojnë ambicie duke luajtur me një sistem që nuk është ai me të cilin janë mësuar më shumë. Dhe, mbi të gjitha, përqendrohuni në lojë pas loje. Mbi të gjitha, duke



pasur një motiv të shkëlqyeshëm për të luajtur këto ndeshje me qetësi", ka shtuar Koeman. Trajneri i Realit të Madridit, Zinedine Zidane, ka kërkuar nga lojtarët t'i harrojnë rezultatet e ndeshjeve të fundit dhe në "El Clasico" të luajnë për fitore. "Duhet të harrojmë çfarë ka

ndodhur. Ne kemi 'El Clasico'-n për ta shfaqësuar vetveten. Çdo ndeshje ka historinë e saj. Është gjëja më e mirë për futbollin. Unë kam qenë gjithmonë kritik ndaj vetes dhe duhet të përmirësohem. Unë gjithmonë do të jem pas lojtarëve të mi deri në vdekje", ka deklaruar Zidane.

Messi: Shpresoj që Ronaldo ta kalojë Covidin dhe të jetë në fushë të mërkurën

BARCELONË, 23 TETOR - Cristiano Ronaldo ka rezultuar përsëri pozitiv me koronavirus dhe ka shumë gjasa që ai ta humbasë ndeshjen e shumëpritur të Ligës së Kampionëve mes Juventusit dhe Barcelonës që zhvillohet të mërkurën. Në një intervistë për DAZN përpara "El Clasico"-s, Messi foli me ngrohtësi për lojtarin që shpesh shihet si rivali i tij i përjetshëm. "Ai me Cristiano Ronaldon ishte dhe është një duel i veçantë, i cili do të mbetet përgjithmonë. Zgati shumë vite dhe nuk është e lehtë të ruash nivele të caktuara për një kohë të gjatë. Ekipet tona ishin gjithashtu shumë kërkuese: Real Madridi dhe Barcelona, dy klubet më të forta në botë. Të garosh si i barabartë për kaq shumë vite është diçka që do të mbetet përgjithmonë. Dueli midis meje dhe Cristiano Ronaldos



ishte shumë i mirë në nivelin personal. Unë mendoj se njerëzit e shijuan këtë gjë", ka thënë Messi, duke shtuar: "Pa dyshim kur Cristiano luante për Real Madridin ndeshjet ishin të veçanta. Ndeshjet kundër tyre gjithmonë janë të veçanta, por me Cristianon në fushë ata kishin një kuptim të veçantë". Argentinasi që ka bërë

histori në Ligën e Kampionëve me Barcelonën, të mërkurën do të përballë me Juventusin, ku shpreson që Ronaldo të jetë në fushë dhe të kalojë sa më shpejt infektimin me Covid-19. "Të mërkurën mund ta kemi këtë sfidë. Shpresojmë që Cristiano të jetë aty dhe sa më shpejt të shërohet nga Covid-19", ka deklaruar Messi.

SHKURT

Muriqi titullar sonte ndaj Bolognas

Trajneri i Lazios, Simone Inzaghi, në një konferencë për media, para ndeshjes me Bolognan në Serinë A, e ka konfirmuar një lajm të mirë për sulmuesin e Përfaqësueses së Kosovës, Vedat Muriqi. Inzaghi ka deklaruar se Muriqi në këtë ndeshje mund të aktivizohet nga minuta e parë. "Muriqi mund të startojë nga fillimi. Të gjithë sulmuesit e mi do të jenë të gatshëm. Muriqi dhe Felipe Caicedo e ndihmuan ekipin kundër Borussia Dortmundit", ka deklaruar Inzaghi. Lazio dhe Bologna përballen duke filluar nga ora 20:45.

Duka: Kampionati do të fillojë së shpejti

I gjithë opinioni sportiv dhe jo vetëm është në pritje të vendimit nga Liga Profesioniste në lidhje me startin e kampionatit që po bojkotohet prej 40-ditësh. Ishte planifikuar që Kategoria Superiore të startonte më 12 qershor, teksa është data 23 tetor dhe ende nuk është zhvilluar java e parë. Ndërkohë, së fundmi, gjatë një aktiviteti në "Football Republic Akademi", presidenti i FShF-së, Armand Duka, është shprehur se ka pasur së fundmi një takim me kryeministrin Edi Rama, teksa i pyetur në një deklaratë për mediat se kur do të startojnë aktivitetet futbolistike, kreu i FShF-së është shprehur, veç të tjerash: "Kampionati do të fillojë së shpejti. Kryeministri më ka premtuar se do ta pranojë ofertën tonë".

Mbrojtësi i Romës infektohet me Covid-19

Pas suksesit në Zvicër, Roma është kthyer në Itali, por lajmi i ditës ka qenë menjëherë i hidhur. Mbrojtësi Gianluca Mancini ka rezultuar pozitiv në testin për Covid-19. Vetë mbrojtësi verdhekuq e njoftoi atë përmes profilit të tij 'Instagram': "Përshëndetje të gjithëve! U testova pozitivisht me Covid dhe për pasojë jam në karantinë. Për fat të mirë unë ndihem mirë dhe tashmë po numëroj ditët mbrapsht për kthimin tim në fushë. Shihemi së shpejti dhe Forza Roma!".

Crespo preferon Messin para Ronaldos

Legjenda e futbollit argjentinas, Hernan Crespo, ka thënë se ai preferon Lionel Messin para Cristiano Ronaldos. "Më vjen keq që shoh një Leo Messi të trishtuar te Barcelona. Ajo është shtëpia e tij. Shpresoj se ai do t'i rifillojë marrëdhëniet e shkëlqyera që kishte më parë ose mund ta vrasë dashurinë midis lojtarit dhe tifozëve", ka thënë Crespo. "Unë jam duke pritur të shoh Juve-Barcelona, por unë do ta zgjidhja Messin para Ronaldos. Leo është një bashkatdhetar, një djalë që pashë duke u rritur. Copa America është në verën e ardhshme, Argjentina dhe Kolumbia janë organizatorët. Shpresoj të mund të shkojmë deri në fund", ka deklaruar ish-sulmuesi i njohur, Hernan Crespo.

Haaland mund të largohet nga Dortmundi për 75 milionë euro

Sulmuesi norvegjez Erling Haaland po vijon formën fantastike në Bundesligë te skuadra e Borussia Dortmundit, ndërkohë që

admiruesit e tij nuk janë të paktë në Evropë. Mediat italiane kohët e fundit kanë kujtuar që sulmuesi mund të lërë Dortmundin verën e

ardhshme, as më pak dhe as më shumë se 75 milionë euro. Një shifër që duket si okazion në merkato, duke parë çmimet në vitet e fundit, kualitetin e

lojtarit dhe moshën e tij shumë të re. Klubet e mëdha si Real Madrid dhe Juventus, pavarësisht nga kriza e shkaktuar nga Covid-19, sërish

nuk do të kursehen për blerjen e supertalentit norvegjez që garanton gola në fazën sulmuese, ku është një vrasar i vërtetë brenda zonës.



MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)

Country	Kosovo
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	Contract for the Construction of Household Efficiency Retrofits (HER)
Procurement Ref. Number	RFQ / 2020/No. 015
Type of Procurement (goods, works or services as applicable)	Works
Employer	Millennium Foundation of Kosovo (MFK)
Publication Date	23 October 2020
Submission Deadline	09 November 2020; 14:00 pm (Kosovo Time)

The Millennium Foundation Kosovo has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the "Threshold Program agreement", and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for the Construction of Household Efficiency Retrofits (HER).

MCC's funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the threshold up-front, with no incremental or partial funding. So, when a contract is signed with an MCA Entity, money is already available to the MCA Entity and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

MFK now invites *password protected bids* from eligible *bidders* for the Works Requirements under IDIQ Contract relate to two specific tasks to be performed by the Contractor. One task is related to the site visit, detail measurements of building and preparation of sub-project Bill of Quantities (Service Order) and another task relates to the energy efficiency works to be provided on the specific household (Works Order).

Bidding will be conducted through the *Shopping* procedures as specified in the MCC Program Procurement Guidelines (PPG), and is open to all eligible bidders or consultants as defined in the PPG.

A complete set of Request for Quotation (RFQ) documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible bidders through the following website (Eventual clarifications or any changes to the RFQ document shall be published at the latest 3 days before the submission deadline on the link provided below):

<https://millenniumkosovo.org/procurement>

A pre-Bid conference shall take place at the 29 October 2020, at 14:00 am (Kosovo Time), through Zoom meeting link: <https://us02web.zoom.us/j/85692269759>

Bidders interested in submitting bids should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the RFQ to the Procurement manager at procurement@millenniumkosovo.org, giving full contact details of the bidder.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link (dropbox link) shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in bids rejection. The File link for submission of bids is included in the RFQ document.

Bids shall be submitted ONLY to the file request link provided in RFQ documents no later than 09 November 2020 at 14:00 (Kosovo Time). Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.

Contact Information:

The address(es) referred to above is (are):	Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Attn:	Arton Çitaku MFK Procurement Manager Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Tel:	00 383 38 752 110
E-mail:	procurement@millenniumkosovo.org
Website:	https://millenniumkosovo.org

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Kosovar Leskovci shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Emin Duraku" Prishtinë.

► Marcel Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Jasir Avdyli shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Silver Shaipi shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Drita Muçaj shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Mitat Rakaj shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: -VII- të shkollës fillore "Lekë Dukagjini", Prizren.

► Miranda Dedaqi shpall të pavlefshme dëftesat e diplomën dhe certifikatën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South



Në bazë të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2, Neni 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit të punës Nr. 03/L-2012, Neni 17 paragrafi 1 të ligjit për Teatro Nr.04/L-106 dhe udhëzimin administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në Sektorin Publik Komuna Mitrovica e Jugut shpall:

KONKURS

Për plotësimin e stafit në Teatrin e Qytetit „Muharrem Qena”

Institucioni – DKRS/ Teatri „Muharrem Qena” Mitrovicë

1. Titulli i pozitës: Kordinator/e për marketing

- Nr i pozitave: 1 (Një)
- Koeficienti: 7.00
- I përgjegjet: Drejtorit të përgjithshëm
- Orari i punës: 1 plotë 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Krijon, zhvillon dhe implementon kampanjat e marketingut me qëllim të promovimit të Teatrit, shfaqjeve dhe aktiviteteve tjera të Teatrit.
- Kordinon punën me përgjegjësit e teatrit për aktivitetet dhe eventet promovuese.
- Menagjon dhe mirëmban aktivisht faqen elektronike të teatrit në Website, facebook dhe prezencën e teatrit në mediat elektronike dhe të shkruara në funksion të promovimit të punës së teatrit.
- Krijon dhe menaxhon disajnerin e PR (Pijarit) për prezantimin e teatrit
- Bën strategjinë promovuese të produkteve të teatrit.
- Merret me organizimin dhe postimin e ftesave, banerave dhe paraqitjen në festivale apo turne.
- Kryen edhe punë tjera që kanë të bëjnë me promovimin e institucionit, programeve, shërbimeve sipas kërkesës të mbikqyrësit bazuar me ligj.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara;

- Pregaditja Universitare (Diploma e Fakultetit)
- Dy vite përvojë pune profesionale
- Njohja e punës praktike administrative dhe të marketingut
- Aftësi të mira menaxheriale
- Aftësi të mira në komunikim verbal dhe të shkruar.
- Të ketë njohuri të mira për funksionimin e Teatrit si institucion dhe art.
- Të jetë i/e motivuar, profesional dhe të ketë qasje pozitive.
- Njohuri e punës me kompjuter, word, excel etj.
- Të jetë fleksibil dhe kreativ duke marrë parasysh edhe kriteret e veshitësuar të punës.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

Kohëzgjatja e emërimit: Të gjithë të pranuarit përmes konkursit publik, marrin kontrata të përherëshme pas periudhës provuese 6 mujore, sipas suksesit dhe angazhimit të treguar të parapara me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Dokumentacioni i kërkuar: • Diploma (Kopja e noterizuar) • fotokopja e letërnjoftimit, ekstrakti i lindjes, dëshmitë mbi përvojën e punës, certifikatën që nuk jeni nën hetim

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën nr. 10 në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe të bashkëngjiten të gjitha dokumentet e lartcekura. Dokumentet duhet të jenë në njërin prej gjuhëve zyrtare të komunës. Kontaktet me telefon mund të bëni në 028 – 532 104 dhe 028 515 559.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga data e publikimit



Mitrovicë 23.10.2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South



Na osnovu člana 8 stavova 1 i 2, člana 10 stav 2 podstav 2.1 Zakona o Radu Br. 03/L-2012, člana 17 stav 1 Zakona o Pozorištu Br.04/L-106 i Administrativnog Uputstva (MRSZ) Br.07/2017 o regulisanju procedura konkursa u Javnom Sektoru, Opština Južna Mitrovica objavljuje:

KONKURS

Za popunu osoblja Gradskog Pozorišta „Muharrem Qena”

Institucija – UKOS/ Pozorište „Muharrem Qena” Mitrovica

1. Naziv pozicije: Kordinator/ka za marketing

- Br. pozicija: 1 (Jedna)
- Koeficijent: 7.00
- Odgovara: Generalnom direktoru
- Radno vreme: Puno radno vreme, 40 časova nedeljno

Zadaci i odgovornosti:

- Stvara, razvija i sprovodi marketinške kampanje u cilju promocije Pozorišta, predstava i drugih aktivnosti Pozorišta.
- Koordinira rad sa pozorišnim menadžerima za promotivne aktivnosti i događaje.
- Aktivno upravlja i održava elektronske stranice pozorišta na web lokaciji, facebook-u i prisustvo pozorišta u elektronskim i štampanim medijima u cilju promocije rada pozorišta.
- Stvara i upravlja PR (Pijar) dizajnerom za prezentaciju pozorišta.
- Vršiti promotivnu strategiju pozorišnih proizvoda.
- Bavi se organizovanjem i objavljivanjem pozivnica, natpisa i nastupa na festivalima ili turnejama.
- Obavlja i druge poslove u vezi sa unapređenjem ustanove, programa, usluga na zahtev pretpostavljenog osnovu zakona.

Potrebna kvalifikacija i sposobnosti;

- Univerzitetsko Obrazovanje (Diploma Fakulteta)
- Dve godine stručnog radnog iskustva
- Poznavanje praktičnog rada u administraciji i marketingu
- Dobre menadžerske veštine.
- Dobre veštine verbalne i pisane komunikacije.
- Da ima dobro znanje o funkcionisanju Pozorišta kao institucije i umetnosti.
- Da bude profesionalno motivisan/a i da ima pozitivan pristup.
- Poznavanje rada na kompjuteru, word, excel itd.
- Da bude fleksibilan/a i kreativan/a uzimajući u obzir i teške kriterijume rada.

Uslovi učešća na konkursu: Pravo na prijavu imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost da deluju i koji imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za izvršenje zadataka.

Trajanje imenovanja: Svi primljeni preko Javnog konkursa, dobijaju trajne ugovore nakon probnog rada od 6 meseci, u skladu sa uspehom i zalaganjem prikazanim gore navedenim propisima.

Zahtevana dokumentacija: • Diploma (Overena kopija) • fotokopija Lične karte, izvod iz matične knjige rođenih, dokazi o radnom iskustvu, potvrda da niste pod istragom

Podnošenje zahteva: Prijave se primaju i podnose u kancelariji br. 10 u Opštini Južna Mitrovica. U prijavi treba jasno da se navede naziv radnog mesta i referentni broj i dodati gorenavedena dokumenta.

Dokumenti trebaju da budu na jednom od zvaničnih jezika Opštine. Možete uspostaviti telefonske kontakte na: 028 – 532 104 dhe 028 515 559.

Prijave poslate nakon poslednjeg datuma i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja.



Mitrovica 23.10.2020



MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

D P A

Departamenti për punë administrative

Mitrovicë /Nr.

Kompania Rajonale Ujësjetllësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.07/2019 për strukturën, përmbajtjen dhe dorëzimin e raporteve financiare vjetore, me datën 23.10.2020 mori vendim për të shpallë:

KONKURS

I. (1) Menaxher për Financa dhe Kontabilitet

Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës:

- kordinimi i punëve të dokumentacionit financiar të të tri njësive (Mitrovicë, Vushtri, Skenderaj),
- pranimi i dokumentacionit dhe shikimi i rregullsisë së tij,
- regjistrimi i tërë dokumentacionit në librat e kontabilitetit,
- regjistrimi i ekstrakteve bankare në librat e kontabilitetit nga bankat ku kompania ka llogarit e hapura si dhe barazimi i tyre me librat e kontabilitetit,
- pranimi i faturave hyrëse, regjistrimi i tyre në kontot adekuate nëpër njësit përkatëse,
- pranimi i fatyrave dalëse si ato të shërbimeve, të ujit, regjistrimi i tyre në librat e kontabilitetit,
- përcjellja e arkës për njësi, arkat e inkasimit ditor dhe arkën e shpenzimeve,
- për secilën njësi arkat e të hyrave dhe shpenzimeve, regjistrimi i tyre në librat e kontabilitetit, barazimi i inkasimeve ditore me shërbimin e inkasimit,
- përpilimi i raporteve financiare mujore, llogaritja e TVSH-së, plotësimi dhe deklarimi mujor i TVSH-së,
- plotësimi dhe deklarimi i formularëve të tatimit në burim,
- plotësimi dhe deklarimi i formularëve për kontribute,
- raportet tremujore në të ardhurat e kompanis dhe dorëzimi i tyre në ATK,
- përpilimi i pasqyrave financiare në bashkëpunim me ZKF si dhe punët plotësuese me urdhër të Kryeshefit Ekzekutiv,
- Pregaditja e dokumentacionit për Auditim të jashtëm si dhe bashkëpunimi me Auditor të Jashtëm,
- Kryen punë dhe detyra tjera sipas Udhëheqësit.
- Përgaditja superiore – Fakteti Ekonomik,
- Të jetë Kontabilist i çertifikuar(obligative),
- Së paku 3 vite përvojë pune,
- Afësi të shkëlqyeshme komunikimi dhe bashkëpunimi me Zyrтарin Kryesor Financiar dhe Zyrтарët e Lartë tjerë të Kompanisë.

Dokumentat e kompletuara të cilat duhet të përfshijnë letren përcjellëse, biografin tuaj (CV-në), kopjen e diplomës përkatëse e noterizuar, dëshmin që është Kontabilist i çertifikuar, referencat dhe çertifikatat- të lindjes, shëndetësore, të mos jetë nën hetime dhe i denuar, letërnjoftimi kopja, dëshmi mbi përvojën e punës etj.

Dokumentacioni dorëzohet i fotokopjuar dhe i njëjti nuk u kthehet aplikantëve.

Aplikacionet merren dhe i tërë dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Drejtorin e KRUM-së, zyra nr. 6.

Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit në të përditshmen Epoka e Re.

Dokumentet që nuk janë të kompletuara sipas konkursit nuk do të shqyrtohen.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në:

Zyra Nr.6

Drejtoria e KRUM.

Rr. Bislim Bajgora pn.

Mitrovicë



Në bazë të dispozitave të Nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, respektivisht dispozitat e Nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Statutit të kompanisë, Bordi i Drejtorë i KRM "UNITETI" Sh.A. Mitrovicë me datë 22.10.2020 me vendimin nr.39, shpall:

KONKURS

Për pozitën: Këshilltar/e i Përgjithshëm/Sekretar/e i Ndërmarrjes

I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve

Vendi: Mitrovicë

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale:

- Kandidati duhet të ketë diplomë në fushën e Fakultetit Juridik (Jurist i diplomuar ose Master në shkencë Juridike);
- Të posedoj së paku pesë (5) vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes, korporatave ose të drejtës së shoqërive tregtare;
- Të plotësoj kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe të plotësoj kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2. pikat (d), (f), (j), (k), (l), të ligjit nr. 03/L-087 të ndërmarrjeve publike dhe plotësimi ndryshimit të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 04/L-111 neni 13;
- Të posedoj njohuri të punës me kompjuter;
- Njohja e gjuhës angleze (e preferueshme)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Shërben si Sekretar/e i Bordit të Drejtorëve.
- Të siguroj përcjelljen e procedurave nga Bordi, ku bëjnë pjesë organizmi i takimeve të Bordit, Komiteteve të Bordit dhe Aksionarëve dhe në bashkëpunim me Kryesuesin e Bordit bën përgatitjen dhe shpërndarjen e rendit të ditës.
- Të mbajë procesverbalin e takimeve dhe ti shpërndaj ato tek Bordi Drejtorët.
- Të mbajë procesverbalin e secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga Kryesuesi i tyre) dhe ti regjistroj ato në librin e protokollit.
- Vepron si agjent i ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve, të bejë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit, Komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe Menaxherëve të lartë të ndërmarrjes.
- Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit të ndërmarrjes duhet të jenë në dispozicion të të gjithë Drejtorëve të Bordit dhe duhet të siguroj që ato përputhen me procedurat e Bordit.
- Të jep këshillat juridike dhe interpretime ligjore për nevojat e Bordit.
- Mirëmban regjistrat e të dhënave të ndërmarrjes,
- Percjell ndryshimet ligjore, që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe Menxhmentin e ndërmarrjes për ndryshimet si dhe përgatit udhëzime të nevojshme për Menaxhmentin në ndërmarrje.
- Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetet përkatëse, siç mund të kërkohet për ligjin për ndërmarrjet publike ose nga statuti i ndërmarrjes.
- Kordinon me KE-në përgatitjen e letrave (dokumente) për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve. Merret me çështje tjera të qeverisjes së ndërmarrjes sipas nevojës.
- Kohëzgjatja e punësimit, të drejtat dhe obligimet përcaktohen me kontratë punësimi në kohë të caktuar për tri (3) vite me mundësi vazhdimi.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën Këshilltar/e i Përgjithshëm/Sekretar/e i Ndërmarrjes duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në e Aplikantit;
- Dëshminë e Shkollimit (Fakulteti Juridik);
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Referenca si dhe çertifikatat tjera profesionale;
- Letër motivimin;
- Deklaratën nën betim (merret nënshkruhet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se tre (3) muaj);
- Kopjen e dokumentit të identifikimit;
- Deklarata nën betim.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit me 24.10.2020 deri me datën **23.11.2020**.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së arkivës pranë kompanisë në Mitrovicë, rruga: "Vëllezërit Draga".

NJË VIT PA TY GJYSH



Halit Bytyqi

(10.02.1926-24.10.2019)

Me dhimbje në shpirt dhe dashuri të pa shuar e kujtojmë humbjen tënde gjysh. Ne nipërit dhe mbesat tua kujtojmë historinë e vërtet që tregoj she për përjetimet e tua dhe familjes në shumë sfera të jetës. Kujtojmë mësimet tua në edukim, ndershmëri, sinqeritet në të mirën tonë shoqërore dhe në atë kombëtare. Krenohem që te patëm gjysh, qoftë dheu I lehtë në parajsë në botën e amshueshme.

Të kujtojmë me mall të pa shuar: Bashkëshortja Sofia

Reja: Nazmija

Nipërit: Gazmendi, Armendi.

Mbesat: Ganimetja, Violeta, Shkurta dhe e gjithë familja.



Në pajtim me nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Paneli për përzgjedhjen e anëtarit joekzekutiv të Bordit të BQK-së, publikon:

RI-SHPALLJE

Për plotësimin e një (1) pozite të anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Profil i kërkuar:

- Person me integritet dhe përgatitje universitare;
- Minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitet apo çështje juridike;
- Njohuri në krijimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të rëndësishme të lidhura me misionin, objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Në mënyrë specifike të plotësojnë kushtet sipas nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-ën;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera paraqet përparësi.

Emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar nga data e emërimit.

Lista e kandidatëve që kualifikohen nga ana e Panelit do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili do të përzgjedh një individ. Miratimi dhe emërimi për këtë pozitë do të bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 84 paragrafi 27, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-ën.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV me detaje dhe një letër motivuese përmes email adresës vijuese: paneli@bqk-kos.org ose në dorë në zarf të mbyllur në arkivin e BQK-së, Rruga Garibaldi nr. 33 në Prishtinë, ose përmes postës në adresë të BQK-së: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (shënim: për pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të BQK-së), Rruga Garibaldi nr. 33,1000 Prishtinë, Kosovë.

Afati i fundit për aplikim është 09 nëntor 2020, në orën 16:00.

Vetëm kandidatët e të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit do të thirren për intervistë.



U skladu sa članom 38. Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo (CBK), Panel za izbor neizvršnih članova Odbora CBK-a, objavljuje:

PONOJNI OGLAS

Za popunjavanje jednog (1) položaja neizvršnog člana Odbora Centralne banke Republike Kosovo

Zatraženi profil:

- Osoba sa integritetom i univerzitetskom spremom;
- Najmanje deset (10) godina profesionalnog ili akademskog iskustva u oblastima ekonomije, finansija, bankarstva, računovodstva ili pravnih poslova;
- Znanje u stvaranju i praćenju sprovođenja važnih politika povezanih sa misijom, ciljevima i zadacima CBK-a;
- Specifično da ispuni uslove iz člana 40. Zakona br. 03/L-209 o CBK-u;
- Znanje engleskog i drugih jezika je prednost.

Imenovanje će biti za mandat od pet godina počevši od datuma imenovanja.

Spisak kandidata kvalifikovanih od strane Panela biće poslat Skupštini Republike Kosovo, koja će odabrati po jednog pojedinca za svaki položaj. Odobrenje i imenovanje za ove položaje izvršice predsednik Republike Kosovo u skladu sa članom 84. stav 27. Ustava Republike Kosovo i članom 38. stav 2. Zakona br. 03/L-209 o CBK-u.

Zainteresovani kandidati treba da dostavljaju CV sa detaljima i motivacionim pismom na sledeću e-mail adresu: paneli@bqk-kos.org ili ručno u zatvorenoj koverti u arhivi CBK-a, ulica Garibaldi br. 33 u Prištini, ili poštom na adresu CBK-a: Centralna banka Republike Kosovo (napomena: za mesto položaj neizvršnog člana odbora CBK-a), Ulica Garibaldi br. 33,1000 Priština, Kosovo.

Krajnji rok za podnošenje prijave je 9. novembar 2020. u 16:00 časova.

Na intervju će biti pozvani samo kandidati koji ispunjavaju uslove konkursa.



Arben Veselaj është gazetar dhe autor i disa librave letrarë. Ka mbaruar studimet themelore dhe ato postdiplomike për letërsi në Universitetin e Prishtinës. Punon redaktor për kulturë në Radiotelevizionin e Kosovës. Në periodikët letrarë dhe shkencorë shqiptarë ka publikuar kryesisht kritikë dhe studime letrare. Disa nga tregimet dhe esetë e tij janë përfshirë në antologji të ndryshme. Në vitin 2001 botoi librin me poezi *Shpërrallosje*, kurse në vitin 2017 studimin *Tema kadareane*. Më 2017, për zhanrin e kritikës dhe të eseistikës, u laureua nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës me Çmimin Vjetor për Letërsi.

Kur e kam lexuar dorëshkrimin *Triptikon arbëresh* të autorit Arben Veselaj më kanë ndodhur tri fenomene: 1. Disa herë më është dashur t'u kthehem disa faqeve përsëdyt, pasi më rrëmbente rrëfimi dhe shpesh nuk arrija të parashikoja asgjë - parashikimet më dilnin huq; 2. Jam kthyer në kohë dhe kam bashkëjetuar, para së gjithash, me De Radën e me Skiroin, pikërisht në sheshin e Shën Mitrit e të fshatrave të tjera arbëreshe të Kalabrisë e të Sicilisë; dhe 3. E kam lakmuar Arbenin që ka shkruar diçka që kam planifikuar së paku nja tri vjet. Një krijim që arrin me i shkakti këto kokëçarje e kënaqësi, unë e përjetoj si kryevepër. E, ky libër ka histori, letërsi, politikë, peizazh... kulmi është shlyerja e kufijve zhanrorë që Arben Veselaj arrin ta bëjë.

Dr. Rrahman Paçarizi

Qasja askematike dhe johistoriciste mbi gjenezën e letërsisë shqipe dhe qytetërimin modern shqiptar, e bën këtë vepër unike dhe me rëndësi në studimet e albanologjisë. Libri *Triptikon arbëresh* i gazetarit dhe studiuesit Arben Veselaj është një adresë e re me vlerë të veçantë për studiuesit dhe hulumtuesit e rinj, mbi shumë të panjohura që qëndrojnë të stivura e të pluhurosura faqeve të historisë së qytetërimit shqiptar. Rrëfyer nga sfondi i një ekspedite personale prej një gazetari e studiuesi të letërsisë, ky libër përbën sintezën e historisë letrare, politike dhe fetare të botës arbëreshe. Thellësia studimore, kombinuar me artin e të rrëfyerit, herë si shtjellim letrar e herë si reportazh, e bën atë shumë të dobishëm edhe për studentët e gazetarisë. Një apoteozë e madhështisë arbëreshe që na mban frymën gjatë të lexuarit.

Dr. Arben Fetoshi

4⁹⁹ €



Triptikon arbëresh

Arben Veselaj

ARBEN VESELAJ TRIPTIKON ARBËRESH

(historikja, estetikja, ikonikja)







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

